



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 358 Akti

Nr. 574 Vendimi
Tiranë, më 18.10.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Brunilda Bektoshi	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 14.10.2022, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Pëllumb Zaimi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektoshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi do t’i nënshtruhej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Brunilda Bekteshi dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 20.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Pëllumb Zaimi, si dhe caktoi kryesuese të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 9.1.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit¹, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 28.9.2022, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Pëllumb Zaimi për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda datës 10.10.2022, nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 29.9.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 12 ditëve. Në datën 10.10.2022 subjekti dërgoi në mënyrë elektronike shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Trupi gjykues, në datën 11.10.2022, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Pëllumb Zaimi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke e njoftuar në të njëjtën datë se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 14.10.2022, në orën 13:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

¹Riadminstruar përmes *e-mail*-it datë 8.9.2022.

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Pëllumb Zaimi u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Pëllumb Zaimi. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 14.10.2022, për të rifilluar në datën 18.10.2022, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Z. Pëllumb Zaimi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 4.7.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të

²Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; si dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaramet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) të datës 26.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi, si vijon:

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 86 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, vol. ***, f. ***, pallati “****”, ndodhur në ***, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë, krijuar me kontratë sipërmarrjeje datë 12.6.2007 + kontratë shitjeje nr. ***, datë 31.8.2016, me vlerë 48.700 euro. Burimi i krijimit: të ardhura familjare + të ardhurat nga shitja e apartamentit në Ç, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 26.4.2016. Vlera: 6.164.870 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.**

³Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 31.8.2016, me palë shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë blerëse Pëllumb Zaimi dhe M.Z, apartament me sip. 86 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë ***, Tiranë, në vlerën 48.700 euro. Nga dita e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 12.6.2007, dhe deri në datën 31.8.2016, është likuiduar ndër vite vlera 37.000 euro, me tre këste sipas mandatpagesave: datë 12.6.2007, likuiduar vlera 22.000 euro; nr. ***, datë 6.6.2008, paguar shuma 10.000 euro; datë 1.9.2008, shuma 5.000 euro. Ndërsa vlera e mbetur 11.700 euro do të likuidohet rregullisht në llogarinë e noteres, sipas transaksioneve bankare të datës 31.8.2016; njoftim debitimi, datë 31.8.2016, nga “Raiffeisen Bank” në vlerën 11.700 euro, nga llogaria e Pëllumb Zaimi, në llogarinë e I.Ç, PF, me përshkrimin “Kalim për këstet e blerjes së apartamentit nga Pëllumb Zaimi”; njoftim debitimi, datë 31.8.2016, nga “Raiffeisen Bank” në vlerën 1.605.000 lekë, nga llogaria e Pëllumb Zaimi, me përshkrimin “Kalim për konvertim”; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.9.2016, në emër të M dhe Pëllumb Zaimi, të apartamentit me sip. 86 m² në Tiranë; kartela e pasurisë së paluajtshme; kontratë sipërmarrjeje datë 12.6.2007, me palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë porositëse Pëllumb Zaimi, të apartamenti me sip. 97.4 m², në adresën ***, Dajt, Tiranë, në vlerën 48.700 euro. Pagesa do të kryhet me këste: kësti i parë prej 22.000 euro është paguar në datën e lidhjes së kontratës; kësti i dytë prej 25.000 euro do të paguhet brenda datës 31.5.2008; kësti i tretë do të paguhet me dorëzimin e certifikatës së pronësisë; vërtetim nr. *** rep., datë 12.6.2007; vendim nr. ***, datë 10.2.2006, i KRRT-së; vendim datë 14.4.2006; planimetria; mandatarkëtim datë 12.6.2007, derdhje nga Pëllumb Zaimi për blerje apartamenti në vlerën 22.000 euro; mandatarkëtim nr. ***, datë 6.6.2008, derdhje nga Pëllumb Zaimi në vlerën 10.000 euro; mandatarkëtim datë 1.9.2008, derdhje nga Pëllumb Zaimi në vlerën 5.000 euro; mandat tërheqje nga llogaria, datë 12.1.2007, në “Raiffeisen Bank”, M.Z, duke mbyllur llogarinë rrjedhëse të depozitës në shumën 1.907.330 lekë; formular njoftimi për tërheqje *cash*, datë 11.1.2007, nga M.Z; marrëveshje për depozitë me afat në “Raiffeisen Bank” në emër të M.Z të shumës 1.882.200 lekë datë 12.7.2006 deri më 12.1.2007; kontratë blerje apartamenti me pagesë të menjëhershme nr. ***, datë 20.2.2002, me palë shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palë blerëse Pëllumb Zaimi dhe M.Z, të apartamentit në katin e 3-të, nr. ***, lagjja “****”, Ç, në shumën 587.609 lekë; mandatpagesë nr. ***, datë 19.11.2001, në vlerën 495.186 lekë; kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 26.4.2016, me palë shitëse Pëllumb Zaimi dhe M.Z dhe palë blerëse Y.K, të apartamentit me sip. 74 m², në lagjen “****”, Ç, z. k. ***, në vlerën 2.700.000 lekë; njoftim debitimi, datë 12.5.2016, nga “Raiffeisen Bank”, nga llogaria e K.M, PF, në llogarinë e

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se:Subjekti nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes, datë 12.6.2007, për apartamentin e banimit me sip. 97.4 m², në ***, në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2007; është deklaruar në vitin 2008; nuk ka deklaruar detyrimin financiar në shumën 11.700 euro në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2007; ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për kryerjen e pagesave me këste të apartamentit në ***, në vitet 2007 - 2008.

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

1.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2008, me përshkrimin “Shtuar: sipërfaqe banimi 97.4 m², në bazë të kontratës së sipërmarrjes datë 12.6.2007, në shumën 48.700 euro. Nga kursimet familjare të viteve të pasura gjendje *cash* në shtëpi, depozita bankare. Kontributi i O.Z (vajza) nga dhuratat e saj në vite, në shumën 37.000 euro. Këmbimi është bërë 1 euro = jo > 120 lekë. Pakësuar 37.000 euro për pagim këstesh, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 12.6.2007”.

1.2.1 Po në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar detyrim të mbetur ndaj shoqërisë shumën 11.700 euro.

Vajza e subjektit të rivlerësimit, si person i lidhur me të, në deklaratën e saj të vitit 2008, deklaroi: “*Të ardhurat nga dhuratat në vite deri në moshë madhore. Gjithsej shuma 4.000 euro = 500.000 lekë. Pakësuar 2.000 euro, dhënë familjes sime gjatë vitit 2008 për mbylljen e kështit të kontratës së sipërmarrjes*”.

1.2.2 Në deklaratat periodike të viteve në vazhdim, konkretisht 2009 - 2015, subjekti ka deklaruar detyrimin e mbetur prej 11.700 euro.

1.2.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “*Shlyerje e kontratës së sipërmarrjes datë 12.6.2007, në shumën totale 48.700 euro ose 6.164.870 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 31.8.2016 dhe pagimi i kështit të fundit të detyrimit të kontratës në shumën 11.700 euro ose 1.605.000 lekë. Të ardhura të siguruara nga shitja e apartamentit në Ç sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 26.4.2016*”.

1.3 Nga korrespondenca e Komisionit me ASHK-në, kjo e fundit, nëpërmjet Drejtorisë Vendore Tirana Rurale⁴, konfirmon se z. Pëllumb Zaimi së bashku me znj. M.Z kanë të regjistruar pasurinë e llojit apartament, me sip. 86 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. *** (pasuri aktive).

Drejtoria Vendore Tirana Rurale¹, ka bashkëlidhur kontratën e shitjes së pasurisë të paluajtshme nr. ***, datë 31.8.2016, ku rezulton se pala shitëse, shoqëria “****” sh.p.k., i ka shitur palës blerëse Pëllumb Zaimi dhe M.Z apartamentin me sip. 86 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në ***, Tiranë, në vlerën 48.700 euro.

1.4 UKT-ja⁵ informon se nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata për shërbime, të regjistruar në sistem në emër të subjektit të rivlerësimit apo familjarëve të tij.

1.4.1 Subjekti ka depozituar⁶ kontratën për shërbime ujësjellës - kanalizime me UKT-në për këtë pasuri, si dhe librezën përkatëse, nga ku konfirmohen pagesat e kryera për këtë operator.

Pëllumb Zaimi, në vlerën 2.7000.000 lekë, me përshkrimin “Të ardhura nga shitblerja e pasurisë në Ç”. Aneks nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴Shkresë përcjellëse nr. *** prot., datë 2.6.2020.

⁵Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

⁶Pyetësor nr.2, datë 7.4.2022.

1.5 FSHU-ja⁷ informon se me gjeneralitetet Pëllumb F Zaimi nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (as familjarët e tij M, O dhe R).

1.5.1 Subjekti ka depozituar⁸ kontratën dhe librezën që i përket furnizimit me energji elektrike, nga ku konfirmohen edhe pagesat e kryera për këtë operator.

1.6 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe likuidimin e saj, nga hetimi administrativ Komisioni konstatoi faktet e mëposhtme:

1.6.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* se burim krijimi për këtë pasuri janë: (i) të ardhura familjare; si dhe (ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Ç, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 26.4.2016.

1.6.2 Rezultoi se kjo pasuri fillimisht është porositur me kontratën e sipërmarrjes⁹ datë 12.6.2007, vërtetuar me nr. *** rep., datë 12.6.2007, me palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palë porositëse Pëllumb Zaimi, për apartamentin me sipërfaqe totale ndërtimi 97.4 m², në adresën: ***, Dajt, Tiranë, në vlerën 48.700 euro. Sipas kësaj kontrate parashikohej se pagesat do të kryheshin me këste, specifikisht: kësti i parë prej 22.000 euro, paguar në ditën e lidhjes së kontratës jashtë zyrës noteriale; kësti i dytë prej 25.000 euro do të paguhej brenda datës 31.5.2008; kësti i tretë prej 1.700 euro do të paguhet me dorëzimin e certifikatës së pronësisë.

1.6.3 Sipas kontratës së shitjes¹⁰ nr. ***, datë 31.8.2016, likuidimi i pasurisë është kryer sipas: (i) mandatpagesës datë 12.6.2007, për shumën 22.000 euro; (ii) mandatpagesës nr. ***, datë 6.6.2008, për shumën 10.000 euro; (iii) mandatpagesës datë 1.9.2008, për shumën 5.000 euro; (iv) ndërsa shuma e mbetur prej 11.700 euro likuidohet rregullisht në llogarinë e noteres, sipas transaksionit bankar datë 31.8.2016, nr. Ref ***, pa asnjë pretendim nga palët.

1.6.4 Komisioni, mbi mënyrën e likuidimit të çmimit për këtë pasuri, vërejtë se parashikimi i likuidimit të kësaj pasurie në kontratën e sipërmarrjes nuk përputhej me atë të kontratës së shitjes.

1.6.5 Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe subjekti i rivlerësimit kanë vendosur në dispozicion dokumentacionin justifikues sipas datave të secilës pagesë të pasurisë, sipas citimit në kontratën e shitjes.

1.6.6 Komisioni, pas administrimit të dokumentacionit lidhur me shlyerjen e çmimit të kësaj pasurie, konstatoi se çmimi i saj ishte shlyer përmes: (i) dy mandatpagesave *cash*, të datës 6.6.2008 për shumën 10.000 euro dhe i datës 1.9.2008 për shumën 5.000 euro; (ii) transaksionit bankar, dhe specifikisht shumën 22.000 euro, të paguar më 12.6.2007, ku subjekti i rivlerësimit ka kryer depozitim në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., në “Emporiki Bank”, me përshkrimin “derdhje nga Pëllumb Zaimi për blerje apartamenti”; (iii) shumën 11.700 euro, të paguar në datën 31.8.2016, subjekti i rivlerësimit e ka transferuar nga llogaria e tij bankare në “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e noteres I.Ç, PF, me përshkrimin “kalim për këstet e blerjes së apartamentit nga Pëllumb Zaimi”.

1.6.7 Nga dokumentacioni i administruar për mënyrën e likuidimit të kësaj pasurie, Komisioni, pasi konstatoi se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007 kontratën e sipërmarrjes dhe as shumën e paguar prej 22.000 euro në datën 12.6.2007, i

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020.

⁸Pyetësor nr.2, datë 7.4.2022.

⁹Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së dhe me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 2.6.2020, nga ASHK-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁰Aneksnr.*** në dosjen e ILDKPKI-së dhe me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 2.6.2020, nga ASHK-ja, në dosjen e Komisionit.

kërkoi shpjegime¹¹ subjektit për këtë fakt, i cili deklaroi se: “Ka qenë një harresë për shkak të situatës së krijuar, pasi me Dekretin nr. 5350, datë 11.6.2007, Presidenti i Republikës ka suprimuar gjykatat e rretheve gjyqësore : Bulqizë, Mirditë, Librazhd, Gramsh, Skrapar, Kolonjë, Përmet, Tepelenë, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1.9.2007. Për periudhën 1.9.2007 – 31.10.2008 kam qenë gjyqtar në pritje me pagën e Kryetarit, ndërsa në datën 1.11.2008, mbi bazën e vendimit nr. ***, datë 13.11.2007, të KBGJL-së, jam emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Pra, kontrata e mësipërme e sipërmarrjes është deklaruar në deklaratën e interesave private periodike/vjetore datë 20.3.2009, pra në deklarinimin e pasurisë së vitit 2008, pasi unë kam menduar së është një kontratë paraprake, e cila edhe nuk mund të finalizohet, pasi ndërtimi i pallatit ishte ende në themele”.

1.6.8 Komisioni hetoi lidhur me ligjshmërinë e secilit burim krijimi për këtë pasuri, për të cilat rezultuan faktet e mëposhtme:

1.6.9 Në lidhje me të ardhurat familjare, Komisioni konstatoi¹² se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë qenë të punësuar në institucione shtetërore dhe, për rrjedhojë, janë konfirmuar të ardhurat e tyre sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.6.10 Ka rezultuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti deklaroi se ka pakësuar 37.000 euro për pakësim këstesh, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 12.6.2007 nga: (i) kursimet familjare të viteve të pasura gjendje *cash* në banesë; (ii) depozita bankare; (iii) kontributi i vajzës nga dhuratat e saj në vite.

Komisioni ka analizuar secilin zë të cituar si kursime të subjektit të rivlerësimit.

i) Lidhur me kursimet e pasura gjendje *cash* në banesë dhe depozita bankare, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet e tij të investuara në depozitë dhe likuiditete *cash* prej vitit 2003 e në vazhdim.

ii) Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit deklaroi kursimet e tij në *cash* prej 200.000 lekësh dhe në depozitë, me përshkrimin “Lekë në depozitë, Banka e Kursimeve Skrapar, në vlerën 750.000 lekë”. Meqenëse nga të dhënat e administruara Komisioni vërejtë se kjo depozitë në “Raiffeisen Bank” identifikohet vetëm prej periudhës 30.12.2004 e në vazhdim, i ka kërkuar¹³ subjektit të depozitë dokumentacion justifikues për të provuar datën e çeljes së depozitës, ndryshimet e pësuar, si dhe interesat e përfituara prej saj. Në përgjigje, subjekti ka depozituar kartelën e depozitës së kursimit pranë Bankës së Kursimeve, dega Ç. Sipas kartelës rezultoi se depozita është hapur në datën 25.9.1997, në vlerë fillestare 30.000 lekë. Komisioni konstatoi se kjo depozitë ka evoluar, subjekti ka kryer depozitime, tërheqje, si dhe ka përfutur interesa, sikurse pasqyrohet në tabelën nr. 1, nga momenti i çeljes deri në vitin 2006, pasi në janar të vitit 2007 ajo është tërhequr.

Tabela nr. 1

Vitet	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006
Shtesa	30,000	100,000	250,000	300,000	200,000	-	-	400,000	516,524	-
Pakësim	-	-	-	-	270,000	-	-	-	-	-
Interesa	2,570	15,242	42,015	39,417	64,419	39,453	53,711	38,353	37,661	24,877

¹¹Pyetësor nr.2, datë 7.4.2022.

¹²Për subjektin: vërtetim nr.*** prot./S.A., datë 24.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vërtetim nr. *** prot., datë 4.1.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Për bashkëshorten: shkresë nr.*** prot., datë 27.10.2016, nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Berat; shkresë nr.*** prot., datë 24.10.2016, nga A; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga Zyra Vendore e Punësimit S; vërtetim nr.*** prot., datë 26.10.2016, për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga Prefekti i Qarkut Berat; vërtetim nr.*** prot., datë 24.10.2016, nga Këshilli i Qarkut.

¹³Pyetësor nr.3, datë 30.5.2022.

Gjendja	32,570	147,812	439,827	779,244	773,663	813,116	866,827	1,305,180	1,858,424	1,882,200
----------------	--------	---------	---------	---------	---------	---------	---------	-----------	-----------	-----------

Nga kartela e kësaj depozite, vihet re se gjendja e saj në fund të vitit 2003 është në vlerën 866.827 lekë dhe jo vlera 750.000 lekë, sipas deklarimit të subjektit.

iii) Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare, sikurse pasqyrohet në tabelën nr. 2, për të parë mundësitë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar këtë depozitë në vlerën 866.827 lekë, si dhe gjendjen *cash* prej 200.000 lekësh të deklaruar po në këtë deklaratë deri në vitin 2003. Në analizën e kryer janë përfshirë të ardhurat nga punësimi për subjektin dhe bashkëshorten, si dhe shpenzimet e identifikuar. Gjithashtu, subjekti është pyetur¹⁴ lidhur me shpenzimet e bëra për arredimin e apartamentit të tij në qytetin e Ç, për të cilat ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime për mobilim, pasi babai i tij ka qenë usta i kategorisë së lartë dhe se ato janë punuar në mënyrë artizanale prej tij, ndërsa lidhur me sendet/orenditë, ato janë dërguar prej vëllezërve të tij nga Greqia, si dhe shpenzimet kanë qenë minimale sipas çmimeve të kohës.

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	1994 – 2003
1	TË ARDHURA	5,263,256
	Të ardhura nga paga subjekti, 1993 – 2000	2,094,293
	Të ardhura nga paga subjekti, 2001 – 2003	1,719,578
	Të ardhura nga paga bashkëshortja, 1994 – 2000	615,673
	Të ardhura nga paga bashkëshortja, 2001 – 2003	576,885
	Të ardhura nga interesat	256,827
2	SHPENZIME	2,914,946
	Shpenzime jetese 1993 – 2000 (66%)	1,788,578
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së, 2001 – 2003	1,126,368
3	PASURI	1,654,436
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Ap. banimi 2+1 sip. 74.6 m ² (ndërtuar në vitin 1994)	587,609
	<i>Likuiditete (banka+cash)</i>	1,066,827
	DIFERENCA (1-2-3)	693,874¹⁵

Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të krijojë depozitën dhe gjendjen *cash* të deklaruar në vlerën 200.000 lekë, si dhe të përballojë të gjitha shpenzimet apo investimet e tjera familjare.

iv) Lidhur me kursimet *cash*, Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar kursime *cash* ndër vite. Gjatë hetimit subjektit iu kërkuan shpjegime¹⁶, të dhënat e të cilave pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3

¹⁴Me pyetësin nr. 5, datë 7.7.2022.

¹⁵Edhe pse Komisioni nuk vendosi apriori një shumë lidhur me shpenzimet e arredimit të pasurisë, vërejtje se balanca e rezultuar është e mjaftueshme për të mbuluar çdo lloj shume të këtij zëri.

¹⁶Pyetësor nr. 3, datë 30.5.2022.

Viti	Përshkrimi i deklarimit të subjektit sipas deklaratave periodike vjetore	Vlera	Shuma e akumuluar	Përlogaritja ¹⁷ e gjendjes cash nga Komisioni
2003	Lekë në cash (paga ime dhe e b/shortes)	200,000	200,000	
2004	Lekë cash në banesë, kursimet e vitit	400,000	200,000	Shuma e akumuluar është në vlerën 200.000 lekë, pasi në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar shtim të depozitës në vlerën 400.000 lekë, derdheje e re në datën 30.12.2004 (200.000 + 400.000 – 400.000)
2005	Lekë cash, kursimet nga të ardhurat familjare gjatë vitit 2005	800,000	1,000,000	200.000 + 800.000
2006	Lekë cash kursimet nga të ardhurat familjare gjatë vitit 2006	700,000	1,700,000	Subjekti pretendon se nga kjo shumë (700.000 lekë), vlera prej 516.000 lekësh është derdhur në depozitën bankare. Ky deklaram nuk është marrë në konsideratë, pasi shuma prej 516.523,85 lekësh është transferuar nga llogaria e tij bankare në atë të depozitës në emrin e bashkëshortes më 30.12.2005. Nuk rezulton depozitim në cash. Pretendimi i subjektit është për vitin 2006, ndërkohë që transferimi ka ndodhur në vitin 2005.
2007	Euro në cash (kursimet nga viti 2007)	€ 8,000	1,914,590	Vjen si rezultat i shumës së cash-it të akumuluar (deri në vitin 2006) 1.700.000 lekë + tërheqja e depozitës në datën 12.1.2007 në vlerën 1.907.330,3 lekë – kësti i apartamentit 22.000 euro + kursimi i vitit prej 8.000 euro.
2008	Shtuar: lekë ose euro. Kursimet familjare gjatë vitit 2008, si dhe kontributi i O.Z nga dhuratat e saj për kontratën e sipërmarrjes	7.000 euro ose 840.000 lekë	906,853	Shumës së akumuluar deri në vitin 2007 i është shtuar shuma 840.000 lekë e vitit aktual dhe zbritur vlera 15.000 euro e dy kësteve të paguara për blerjen e apartamentit.
2009	Kursimet e familjes sime, për vitin 2009 (lekë cash në shtëpi + lekë në llogarinë e Pëllumb Zaimit në "Raiffeisen Bank", S (500.000)	196,754.14	1,103,607	Shumës 500.000 lekë i është zbritur gjendja në llogarinë bankare të subjektit prej 303.245,86 lekësh në "Raiffeisen Bank", për të nxjerrë kursimin në cash dhe shtuar gjendjen e vitit 2008.
2010	Kursimet e familjes nga të ardhurat e vitit 2010	280,000	1,383,607	Në këtë vit subjekti deklaroi edhe kontratën e shitblerjes së automjetit në vlerën 200.000 lekë. Në pyetësorin nr. 3 subjekti pretendon pakësim të gjendjes cash me 200.000 lekë, ndërkohë nuk është deklaruar ky pakësim dhe burimi i krijimit të automjetit. Edhe kur është pyetur për burimin e automjetit, subjekti nuk e ka deklaruar pakësimin e kësaj shume. (1.103.607 + 280.000 lekë)
2011	Kursimet nga të ardhurat e krijuara të familjes gjatë vitit 2011 (nga paga)	100,000	1,483,607	(1.383.607+100.000 lekë)

v) Komisioni ka konstatuar se pas vitit 2011 subjekti nuk ka deklaruar asnjë shtesë apo pakësim dhe në këto rrethana e ka mbartur gjendjen e vitit 2011 (1.483.607 lekë) të pandryshueshme edhe në vitet në vazhdim. Në këtë drejtim, edhe pse subjekti ka deklaruar¹⁸ gjatë hetimit se gjendja cash e vitit 2011 nuk ekziston më, pasi është shpenzuar, Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë këtë deklaram, për sa kohë që subjekti nuk ka deklaruar pakësim të saj.

vi) Komisioni, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, analizoi mundësinë financiare të subjektit për krijimin e kursimeve cash vit pas viti, sikurse pasqyrohet në tabelën nr. 4. Nga analiza financiare Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në vlerën 212.256 lekë për vitin 2005 dhe në vlerën 162.414 lekë për vitin 2008, të krijojë kursimet në cash, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008
1	TË ARDHURA	947,389	1,362,983	1,578,351	1,670,322	1,748,914	1,190,927

¹⁷Bazuar edhe në shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2022, të "Raiffeisen Bank" për kursimet cash për vitet 2005 – 2010, ku pasqyrohen tërheqjet e herëpashershme nga llogaria e tij bankare.

¹⁸Pyetësor nr.3, datë 30.5.2022.

	Të ardhura nga paga, subjekti	679,494	1,067,444	1,261,765	1,312,746	1,330,655	863,900
	Të ardhura nga paga, bashkëshortja	214,184	257,186	278,925	332,699	392,640	327,027
	Të ardhura nga interesat	53,711	38,353	37,661	24,877	25,619	-
2	SHPENZIME	375,456	375,456	438,228	438,228	546,480	546,480
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	375,456	375,456	438,228	438,228	546,480	546,480
3	PASURI	253,711	438,353	1,352,379	725,242	984,709	806,861
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme						
	Ap.banimi 97.4 m ² , kontratë sipërmarrje, datë 12.6.2007 (48.700 euro)	-	-	-	-	2,660,020	1,847,738
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	253,711	438,353	1,352,379	725,242	(1,675,311)	(1,040,877)
	DIFERENCA (1-2-3)	318,222	549,174	-212,256	506,852	217,724	-162,414

1.7 Lidhur me kontributin e vajzës së subjektit të rivlerësimit, krijuar nga dhuratat ndër vite, ka rezultuar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, kur subjekti deklaroi investimin e kryer në blerjen e apartamentit, një nga burimet e përdorura për këstet e pasurisë referuar prej tij është kontributi i vajzës nga dhuratat e saj në vite. Gjithashtu, edhe vajza e subjektit O.Z, në deklaratën e saj si person i lidhur me subjektin, ka deklaruar: *“Të ardhurat nga dhuratat në vite deri në moshë madhore, gjithsej shuma 4.000 euro = 500.000 lekë. Pakësuar, dhënë familjes time gjatë vitit 2008, për mbylljen e kështit të kontratës sipërmarrjes. Vlera 2.000 euro”*.

i) Lidhur me burimin e krijimit të kësaj dhurate, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar disa herë për këtë fakt, konkretisht: (a) në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 30.10.2014, subjekti ka deklaruar se vajza është fëmija i parë. Vëllezërit emigrantë, sa herë që vinin, jepnin dhurata të ndryshme për vajzën dhe vlera 4.000 euro është krijuar nga likuiditeti i dhënë nga ata; (b) në pyetësin standard ka deklaruar se burim i kësaj dhurate është kumaraja ndër vite dhe mandatpagesë nr. ***, datë 4.12.1996, në shumën 44.000 lekë; (c) në pyetësin nr. 3, datë 2.6.2022, subjekti ka deklaruar se burim është kumaraja e vajzës nga data e lindjes deri në vitin 2008. Gjithashtu, kjo shumë është krijuar edhe nga të ardhurat nga fondacioni bamirës “***”, me nr. serial ***, nr. ***, datë 4.12.1996, me emrin O.P.Z.

ii) Komisioni, në fazën e hetimit, nuk e konsideroi shumën e dhuruar nga secili familjar, pasi të ardhurat nuk provoheshin me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe nuk konsideroi as të ardhurat në vlerën 44.000 lekë të përfituara nga fondacioni bamirës “***”, të pretenduara nga subjekti, pasi vërejtë se kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratën për vitin 2003 dhe në vijim, por është deklaruar vetëm gjatë hetimit të Komisionit.

1.8 Komisioni, në vijim për këtë pasuri, analizoi të dhënat e dala lidhur me pagesat e likuidimit të kësaj pasurie, me qëllim kryerjen e analizës financiare për secilin këst të paguar të saj, e cila u bazua në dokumentacionin justifikues, nga ku rezultoi se likuidimet janë kryer në datat 12.6.2007, 6.6.2008 dhe 1.9.2008.

1.9 Lidhur me burimin e secilës pagesë, subjekti ka shpjeguar¹⁹ se: (i) për këstin e parë 22.000 euro në datën 12.06.2007 janë përdorur tërheqja e depozitës bankare në “Raiffeisen Bank” në datën 12.1.2007, në shumën 1.907.330 lekë, konvertuar në 15.800 euro, si dhe kursimet familjare në vitin 2005 në shumën 800.000 lekë, konvertuar në 6.652 euro; (ii) për këstin e dytë 10.000 euro në datën 6.6.2008 janë përdorur pjesa e mbetur e kursimeve të vitit 2005 në shumën 452 euro, kursimet familjare të vitit 2006 në shumën 184.000 lekë, konvertuar në

¹⁹Pyetësor nr.2, datë 7.4.2022.

1.530 euro dhe kursimet familjare të vitit 2007 në shumën 8.000 euro; (iii) për këstin e tretë 5.000 euro në datën 1.9.2008 janë përdorur kursimet familjare të harkut kohor janar – gusht 2008 në shumën 3.000 euro + 2.000 euro dhuratë nga vajza O.Z.

1.10 Komisioni, në analizë të të dhënave të dala nga faktet, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare (sikurse pasqyrohet në vijim në tabelën nr. 5), përkatësisht për pagesën e këstit të parë datë 12.6.2007, meqenëse subjekti i rivlerësimit ka shtuar dhe pakësuar kursimet e tij *cash* dhe ka deklaruar se këtë vit ka kursyer 8.000 euro, deri në fazën e hetimit vlerësoi që gjendja *cash* e akumuluar në analizën e kryer të jetë në vlerën 4.000 euro. Ndërsa, për pagesat e kryera në vitin 2008, Komisioni, duke konstatuar se: (i) për këstin e dytë të paguar në datën 6.6.2008 gjendja *cash* në fund të vitit 2007 është mëse e mjaftueshme për ta mbuluar këtë pagesë; (ii) në kushtet e pamundësisë për të përcaktuar saktësisht shumën e kursimeve *cash* deri në qershor të vitit 2008; si dhe (iii) nisur nga shpjegimi i subjektit se si burim janë përdorur kursimet e viteve të mëparshme – vlerësoi të kryejë analizën financiare për pagesën e këstit të dytë dhe të tretë në një analizë të vetme, duke marrë në konsideratë nga njëra anë deklarin e subjektit se kursimet e tij janë përdorur në harkun kohor janar – gusht në vlerën 3.000 euro, por nga ana tjetër, duke mos përfshirë në këtë analizë si të ardhur shumën prej 2.000 euro, dhuratë nga vajza.

Tabela nr. 5

Nr.	Përshkrimi	12.6.2007	1.1 – 1.9.2008
1	TË ARDHURA	775,171	840,284
	Të ardhura nga paga, subjekti	627,731	622,400
	Të ardhura nga paga, bashkëshortja	147,440	217,884
2	SHPENZIME	273,240	364,320
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	273,240	364,320
3	PASURI	991,365	635,713
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme		
	Ap.banimi 97.4 m ² kontratë sipërmarrje, datë 12.6.2007	2,660,020	1,847,738
	<i>Ndryshim likuiditeti (banka+cash)</i>	(1,668,655)	(1,212,025)
	DIFERENCA (1-2-3)	(489,434)	(159,749)²⁰

1.11 Nga analiza financiare për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi në vlerën 649.183 lekë, të paguante këstet e saj, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

1.12 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Ç, me kontratën e shitjes nr. *, datë 26.4.2016**

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e deklaroi shitjen e pasurisë apartament në qytetin e Ç, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, me përshkrimin “Pakësuar pasuria nr. ***, apartament banimi në Ç, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 26.4.2016, në vlerën 2.700.000 lekë”. Po ashtu, ka rezultuar se në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar: “*Shlyerje e kontratës së sipërmarrjes, datë 12.6.2007, në shumën totale 48.700 euro ose 6.164.870 lekë, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 31.8.2016, dhe pagimi i këstit të fundit të detyrimit të kontratës në shumën 11.700 euro ose 1.605.000 lekë. Të ardhura të siguruar nga shitja e apartamentit në Ç, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 26.4.2016*”.

²⁰Në këtë analizë nuk është përfshirë dhurimi i bërë nga vajza e subjektit.

1.13ZQRPP-ja Tiranë²¹, me shkresat nr. ***, datë 10.8.2017 dhe datë 9.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Skrapar, e cila konfirmon se shtetasit Pëllumb dhe M.Z kanë pasur të regjistruar pasurinë e llojit apartament me sip. 74 m², me nr. ***, z. k. ***, vol. *** f. ***, Ç. Pasuria është përfituar nga kontrata e shitjes nr. ***, datë 20.2.2002, nga Enti Kombëtar i Banesave, ku subjekti ka paguar shumën 587.609 lekë. Këtë pasuri bashkëshortët ia kanë shitur me kontratën e shitjes nr. ***, datë 26.4.2016, shtetasit Y.K, në vlerën 2.700.000 lekë.

1.14Nga hetimi rezulton se në llogarinë bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank” është transferuar në datën 12.5.2016 shuma 2.700.000 lekë, nga noterja K.M PF, me përshkrimin“të ardhura nga shitblerja e pasurisë të ndodhur në Ç, Skrapar”. Në datën 31.8.2016 subjekti ka konvertuar shumën 1.605.000 lekë në 11.700 euro dhe brenda të njëjtës datë e ka transferuar në llogarinë e noteres I.Ç, PF, me përshkrimin“kalim për këstet e blerjes së apartamentit nga Pëllumb Zaimi”.

1.15Komisioni e ka pyetur²² subjektin e rivlerësimit lidhur me pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie dhe në përgjigjen e tij ka sqaruar se në vitin 2011 ka kryer rivlerësimin e kësaj pasurie në vlerën 2.700.000 lekë. Meqenëse diferenca mes çmimit të shitjes dhe vlerës së pasurisë është 0 (zero), subjekti nuk ka pasur detyrimin për të paguar tatim. Lidhur me shpenzimet e kryera për rivlerësimin²³ e kësaj pasurie, Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare për vitin 2011. Në këto rrethana, Komisioni, në analizë të kontratës së shitjes, e cila për nga forma, por edhe nga pasojat e prodhuara, rezulton sipas legjislacionit civil, pasi ka parashikuar palët kontraktore, objektin, ka përcaktuar vlerën e shitjes së pasurisë, është nënshkruar me vullnetin e lirë të palëve, duke u regjistruar në hipotekë në favor të blerësit, nuk vëren ndonjë problematikë për krijimin e shumës 2.700.000 lekë të përfituar nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2016, e përdorur gjithashtu si një ndër burimet e krijimit të pasurisë apartament, objekt vlerësimi.

1.16 Për sa i përket mundësisë financiare për të investuar në blerjen e këtij apartamenti në vitin 2002, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika, sikurse pasqyrohen të dhënat në tabelën nr.6.

1.17 Komisioni, për të verifikuar mundësitë financiare të subjektit, kreu edhe analizën financiare në datën e kryerjes së pagesës, nga ku rezultoi si më poshtë:

Tabela nr. 6

Nr.	Përshkrimi	31.8.2016
1	TË ARDHURA	4,123,295
	Të ardhura nga paga subjekti	934,283
	Të ardhura nga paga vajza	223,516
	Të ardhura nga paga djali	265,496
	Të ardhura nga shitja e ap. Ç (datë 26.4.2016)	2,700,000
2	SHPENZIME	952,147
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	783,640
	Shpenzime qiraje	40,000
	Shpenzim donacioni për z. F.M	27,054
	Shpenzime TIMS	27,054
	Shpenzime shkollimi	74,399

²¹Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së.

²²Pyetësor nr.3, datë 1.6.2022.

²³Pyetësor nr.3, datë 1.6.2022, me të cilin është bashkëngjitur kartela e pasurisë, ku RVP evidentohet te shënimet e veçanta dhe sipas mandatpagesave të kryera nga subjekti për rivlerësimin e pasurisë.

3	PASURI	2,551,754
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Ap. banimi 97.4 m ² , kontratë sipërmarrje datë 12.6.2007	1,605,000
	<i>Ndryshim likuiditeti (banka+cash)</i>	946,754
	DIFERENCA (1-2-3)	619,394

1.18 Nga përlogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave nga shitja e apartamentit në Ç dhe se subjekti ka pasur mundësi financiare të paguajë këstin e fundit të kësaj pasurie, si dhe të përballojë të gjitha shpenzimet apo investimet e tjera familjare.

1.19 Komisioni hetoi edhe lidhur me gjendjen e konfliktit të interesit, për të cilën subjekti²⁴ ka deklaruar se: “Nuk kam gjykuar asnjë çështje civile, penale, familjare dhe administrative ndaj shtetasve A.K, si dhe ndaj shoqërisë ‘***’ sh.p.k. me administrator A.K”. Gjithashtu, subjekti ka depozituar shkresë²⁵ nga institucioni punëdhënës, i cili, në përgjigjen e tij, në asnjë rast nuk konfirmon shqyrtimin e çështjeve ku pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi të kenë qenë shoqëria “***” sh.p.k. apo shtetasi A.K, administrator i saj.

Në të tilla kushte, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë lidhur me këtë çështje.

1.20 Komisioni ka hetuar edhe lidhur me ndonjë trajtim preferencial të mundshëm në favor të subjektit, lidhur me shumën e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie. Për këtë i është referuar udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit ‘k’, për vitin 2007”. Sipas këtij akti rezultojnë se çmimi lekë/m², sipërfaqe shfrytëzimi për vitin 2007 për qytetin e Tiranës, është 97.000 lekë/m². Meqenëse ky çmim ishte mesatare për qytetin e Tiranës dhe pasuria e subjektit është në periferi, Komisioni i është referuar çmimeve të vitit 2008, ku Tirana është ndarë me zonë. Në zonën ku ndodhet apartamenti i subjektit, më konkretisht 3/2, çmimi është 62.500 lekë/m². Apartamenti i blerë nga subjekti është me sipërfaqe 86m². Duke u bazuar në çmimet referuese për zonën 3/2 rezultojnë se vlera e apartamentit është 5.375.000 lekë. Kjo vlerë rezultojnë të jetë më e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 48.000 euro ose 6.112.758 lekë. Pra, rezultojnë se apartamenti është blerë 737.758 lekë më shtrenjtë nga vlerat e tregut (6.112.758 – 5.375.000), duke konstatuar në këtë mënyrë se vlera e cilësuar në kontratë, për blerjen e kësaj pasurie, nuk ka synuar trajtimin preferencial ndaj subjektit.

1.21 Në vijim të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni²⁶ i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve të rezultuara përgjatë hetimit, si dhe i ka kërkuar shpjegime, pasi dukej se subjekti: (i) nuk kishte pasur mundësi financiare në vlerën 212.256 lekë për vitin 2005 dhe në vlerën 162.414 lekë për vitin 2008, për të krijuar kursimet në *cash*, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (ii) kishte kryer deklaram të pasaktë lidhur me kursimet e tij në *cash*, për shkak se pas vitit 2011 nuk kishte deklaruar pakësimin e kësaj gjendjeje, pasi në deklaratën *Vetting* nuk dispononte kursime në *cash*; (iii) nuk kishte pasur mundësi në vlerën 649.183 lekë të paguante këstet e kësaj pasurie, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare; (iv) nuk kishte deklaruar në deklaratën e interesave private periodike/vjetore 2007 kontratën e sipërmarrjes datë 12.6.2007²⁷, për apartamentin e banimit me sip. 97.4 m², të ndodhur në ***, si dhe pagesën e këstit të parë prej 22.000 euro.

²⁴Pyetësor nr. 2, datë 7.4.2022.

²⁵Nr. *** prot., datë 13.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

²⁶Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

²⁷Kjo kontratë dhe pagesat janë deklaruar në vitin 2008.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.22Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka parashtruar disa pretendime lidhur me përlllogaritjen e analizës financiare për vitet 2004, 2005, 2006 dhe 2008. Më konkretisht, subjekti ka pretenduar të ardhura më të larta për të dhe bashkëshorten, duke depozituar shkresën nr. *** prot., datë 14.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ndërsa për bashkëshorten ka sqaruar se punëdhënësi A ka paguar shpërblime vjetore dhe për këto vite ka depozituar vendimet e A²⁸.

1.23Subjekti i ka kërkuar Komisionit që në analizën financiare të marrë në konsideratë në rilllogaritjen e shpenzimeve për jetesë sipas ILDKPKI-së, përfitimin e kuotës ushqimore 100 lekë/ditë që bashkëshortja ka marrë nga shoqëria²⁹ A, e cila ka pësuar rritje vit pas viti, deri në shumën maksimale 400 lekë. Pra, sipas subjektit, Komisioni ose duhet të ulë shpenzimet jetike për të gjithë këto vite ose duhet të rrisë të ardhurat.

1.24 Lidhur me balancën negative për vitin 2007, subjekti ka kontestuar llogaritjet e Komisionit të kryera deri në datën 12.6.2007, pasi sipas tij, pavarësisht se pagesa e këstit të parë është bërë në këtë datë, kursimet e vitit 2007 nuk janë përdorur për këtë këst. Subjekti ka paraqitur situatën e tij financiare, duke parashtruar se në fillim të vitit 2007 ka pasur gjendje financiare *cash* 3.607.330 lekë (tërhequr nga banka 1.907.330 lekë depozitë) dhe gjendja *cash* është në datën 1.1.2007 në shumën 1.700.000 lekë, që vinte e akumuluar nga vitet e mëparshme. Sipas subjektit, kësaj shume po t'i shtohen të ardhurat e 6-mujorit të parë të vitit 2007 dhe të zbriten shpenzimet, atëherë rezulton se ka pasur mundësi financiare të paguajë këstin e parë të pagesës në vlerën 22.000 euro. Ndërsa për pagesat e kryera për këstin e dytë dhe të tretë të vitit 2008, subjekti ka parashtruar se gjendja *cash* dhe të ardhurat në këtë vit mbulojnë pagesën e kësteve të kësaj periudhe. Nën këto kontestime, subjekti i ka kërkuar Komisionit të rishikohen përlllogaritjet sa i takon zërit “vlerë e përcaktuar... ndryshim likuiditeti (banka+arka për periudhat 1.1.2007 – 12.6.2007 dhe 1.1.2008 – 1.9.2008)”.

1.25 Në vijim, subjekti ka kontestuar llogaritjet e Komisionit për shpenzimet jetike, pasi sipas tij kostoja e jetesës së tij në Skrapar nuk mund të jetë njësoj me jetesën në Tiranë, por është pothuajse 50% më e lirë.

1.26 Lidhur me interesat e përfituara nga të ardhurat në fondacionin “***”, si dhe lidhur me dhënien e huas me interesa shoqërisë “***” sh.p.k., për të cilat ka deklaruar se ka përfitur interesa në shumën 237.875 lekë (66.000 +171.875), ka theksuar se në bazë të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ardhurat të përfituara nga interesat janë të tatueshme. Agjent të tatimit në burim janë institucione të licensuara dhe dhënëse të interesave. Nuk ka të drejtë personi privat apo qytetari të mbledhin tatimin në burim, është detyrë ligjore për mbledhjen e tatimeve në burim nga agjentët tatimorë.

Pamundësia e shtetit për të marrë nga agjentët tatimorë detyrimet për tatimin në burim nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, duke mos i njohur si të ardhura këto interesa, kur në fakt ka sjellë ndryshime të kapitalit financiar.

1.27 Në përfundim, subjekti ka parashtruar se në tërësi është dakord me analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe se nuk ka kundërshtime as me rezultatet e hetimit dhe as me metodologjinë e përdorur.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

²⁸Vendim nr. ***, datë 5.7.2004 (shkresa nr. *** prot., datë 6.7.2004) dhe vendim nr. ***, datë 13.12.2004 (shkresa nr. *** prot., datë 13.12.2004) të A; vendim nr. ***, datë 5.4.2005 (shkresa nr. *** prot., datë 6.4.2005) të A; sipas vendimit nr. ***, datë 30.5.2006 (shkresa datë 30.5.2006) të A.

²⁹Sipas vendimit nr. ***, datë 11.12.2000 (shkresa nr. *** prot., datë 12.12.2000).

1.28 Trupi gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

i. Në lidhje me pretendimin e subjektit se të ardhurat e përfituara nga punësimi i tij duhet të pasqyrohen në analizën financiare sipas shkresës nr.583 datë 14.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi në analizë financiare janë përfshirë vetëm pagat dhe shpërblimet, të cilat janë përlllogaritur sipas *statement*-it bankar dhe ku e ardhura (paga) është përfshirë në atë muaj apo vit në të cilën është përfituar. Nga ana tjetër, bazuar në vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat të cilit i referohet subjekti, Komisioni konstaton se në këtë dokument, përveç pagave dhe shpërblimeve, pasqyrohen edhe dietat e përfituara. Vlera e dietave përbën pikërisht diferencën e shumës së pretenduar nga subjekti. Për mospërfshirjen e vlerës së dietave, Komisioni është bazuar në jurisprudencën e Kolegjit³⁰, sipas së cilës e ardhura e përfituar në formën e dietës jepet me qëllim rimbursimit dhe jo si një mundësi për kursim.

ii. Ndërsa, lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, Komisioni i qëndron përlllogaritjeve sipas vërtetimit nr.*** prot., datë 24.10.2016, të A, depozituar nga subjekti së bashku me deklaratën *Vetting*, në të cilin nuk rezulton i përfshirë ndonjë shpërblim i mundshëm. Edhe në dokumentin e depozituar nga subjekti në prapësimet e tij, shkresa nr.*** prot. datë 13.4.2022, e DRSSH-së Berat, Komisioni konstaton se në të pasqyrohet vetëm paga mujore dhe nuk ka të dhëna për shpërblim.

iii. Lidhur me pretendimin e subjektit për të ardhura të tjera të përfituara nga bashkëshortja e tij, sipas vendimeve³¹ të punëdhënësit, shoqërisë “A” për periudhën 2004 – 2006, trupi gjykues çmon se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se në këto vendime citohet marrja e shpërblimit nga një deri në dy paga, porse mbetet i paprovuar fakti i marrjes efektive të tyre në numër dhe në vlerë. Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues çmon se përfshirja ose jo e vlerës së shpërblimit të pretenduar për vitet 2004 dhe 2006 nuk ka efekt, pasi rezultati financiar në këto vite rezulton pozitiv, ndërsa viti 2005 mbetet sërish në një balancë negative në vlerën 212.256 lekë. Për vitin 2008, Komisioni i qëndron përlllogaritjeve sipas vlerave të pasqyruara në *statement*-in bankar, ku pas rilllogaritjeve të kryera subjekti rezulton me një balancë negative në vlerën 142.189 lekë.

iv. Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen në përlllogaritjet e analizës financiare të të ardhurave në formën e kuotës ushqimore 100 - 400 lekë në ditë, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk merret në konsideratë, pasi kjo e ardhur jepet me qëllim për mbulimin e shpenzimeve dhe jo si një mundësi për kursim. Sa i përket pretendimit për reduktim të shpenzimeve të jetesës për vitet 2003-2012, kohë kur subjekti ka deklaruar se ka jetuar në

³⁰Vendim nr. *** datë 5.4.2019, f. ***, citon: “Trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e deklaruara nga subjekti si të përfituara në formën e dietës janë vlera monetare të destinuara për të mbuluar shpenzimet e kryera nga zyrtarët gjatë veprimtarisë së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrës dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim marrëdhënien e punës, sipas nenit 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

³¹Vendim nr. ***, datë 5.7.2004 (shkresa nr. *** prot., datë 6.7.2004), e A; vendim nr.***, datë 13.12.2004 (shkresa nr.*** prot., datë 13.12.2004), e A; vendim nr.***, datë 5.4.2005 (shkresa nr.*** prot., datë 6.4.2005), e A; vendim nr.***, datë 30.5.2006 (shkresa nr.... datë 30.5.2006), e A.

Skrapar, vlerësohet se ky pretendim nuk qëndron, pasi shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për minimum jetik.

v. Sa i takon çështjes së vlerësimit për pagesat e kësteve të pasurisë apartament në vitet 2007 - 2008, trupi gjykues, bazuar në faktet e dala të hetimit dhe analizës financiare së kryer për çdo burim për këto pagesa në raport me pretendimet e subjektit, arsyeton si vijon:

vi. Lidhur me këstin e parë të paguar në datën 12.6.2007, për të cilën subjekti ka pretenduar që analiza të mos kryhet në këtë datë, pra kur është paguar kësti, por të kryhet vjetore, pasi ka përdorur si burim për këtë pagesë kursimet e viteve të kaluara, Komisioni vlerëson se në kushtet që përgjatë hetimit provohet se gjendja *cash* e subjektit të rivlerësimit në datën 31.12.2006 është në vlerën 1.700.000 lekë, bashkëshortja e tij në datën 12.1.2007 ka tërhequr të gjithë shumën në depozitën pranë “Raiffeisen Bank” në vlerën 1.907.330 lekë, duke rezultuar kështu shuma totale 3.607.330 lekë (*cash* + depozita), atëherë kjo vlerë është mëse e mjaftueshme për të paguar këstin e parë në shumën 22.000 euro. Në analizën vjetore të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, rezultati financiar është pozitiv, pra rezulton se subjekti ka pasur mundësi të kryejë pagesën e këstit të parë, të përballojë shpenzimet familjare, si dhe të krijojë kursimet. Nga ana tjetër, nga përlllogaritjet financiare mbi mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit në datën e investimit, jo vetëm për të kryer këtë pagesë, por edhe për të përballuar shpenzimet familjare, si dhe për të krijuar kursimet e tij në datën 12.6.2007³², trupi gjykues çmon se edhe nëse aplikohet marzhi i mundësisë së kursimit 0 (zero) në datën 12.6.2007, rezulton se mundësia financiare e subjektit për të paguar këtë këst, si dhe për të përballuar shpenzimet, është në balancë të papërfillshme negative prej 5.794 lekësh. Pra, edhe nëse i qëndrohet variantit që deri në datën 12.6.2007 kursimi i subjektit ishte zero, duke analizuar transaksionet e kryera prej tij dhe, më konkretisht, tërheqjen nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” të shumës 750.000 lekë në datën 10.8.2007, si dhe shumës 272.000 lekë në datën 24.12.2007, rezulton se subjekti ka pasur mundësi të krijojë shumën 8.000 euro *cash* në gjashtëmujorin e mbetur të vitit.

vii. Lidhur me pagesat e kryera në vitin 2008, Komisioni konstaton se pas rilllogaritjeve të pagës së bashkëshortes sipas *statement*-it bankar dhe mospërfshirjes së shumës 2.000 euro, dhuratë e bërë nga vajza e subjektit, për të cilën ky i fundit nuk depozitoi dokumentacion provues lidhur me burimin e krijimit, rezultati financiar në datën e pagesës është i pandryshuar, ndërsa ai vjetor mbetet me një balancë negative në vlerën 142.189 lekë.

1.29 Në përfundim për sa arsyetohet, trupi gjykues çmon se subjekti rezulton me një balancë negative në shumën 212.256 lekë për vitin 2005 dhe në shumën 142.189 lekë për vitin 2008.

1.30 Trupi gjykues, nisur nga masa dhe dinamika e pamjaftueshmërisë financiare të lartpërmendur, vlerëson se bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në raport me rezultatet e tjera në tërësinë e procesit të rivlerësimit, pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur në vlerën totale -354.445 lekë nuk mund të ngrihet në nivelin³³ e një shkaku shkarkimi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2. Automjet tip “Mercedes-Benz E250D”, viti i prodhimit 1994, deklaruar në deklaratën Vetting nga subjekti i rivlerësimit, krijuar me kontratën e shitjes nr. *, datë 12.7.2010, në**

³²Në deklaratën periodike të vitit 2007, subjekti ka deklaruar shumën 8.000 euro si kursim. Komisioni, në pamundësi për të përcaktuar vlerën e saktë të kursimeve *cash* deri në datën e pagesës, ka vlerësuar ta ndajë kursimin prej 8.000 euro në mënyrë të barabartë për çdo muaj. Kjo shumë (kursimi) është hipotetike, pasi nuk mund të përcaktohet koha e saktë e kursimit.

³³Shihni vendimet nr. *** (JR), nr. *** (JR) dhe nr.*** (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

shumën 200.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat familjare. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën kontratën³⁴ përkatëse.

2.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.

2.2 Nga hetimi administrativ për këtë pasuri ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore 2010, me përshkrimin “Kontratë shitblerjeje automjeti nr.***, datë 12.7.2010 (Benz), në vlerën 200.000 lekë”. Në këtë deklaramin subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

2.3 DPSHTRR-ja³⁵ konfirmon se z. Pëllumb F Zaimi ka të regjistruar automjetin me targa ***, i cili aktualisht rezulton me statusin i çregjistruar.

Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion kontratën e shitjes nr. ***, datë 12.7.2010, të automjetit tip “Mercedes-Benz E250D”, me targa ***, me palë shitëse M.K dhe palë blerëse Pëllumb Zaimi, në vlerën 200.000 lekë.

2.4 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni e ka pyetur subjektin, i cili, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “Automjeti është blerë nga ana ime në datën 12.7.2010 në shumën 200.000 lekë nga të ardhurat e pagave të mia dhe bashkëshortes time, si dhe shpërblimi i marrë nga bashkëshortja M.Z për shkak të reformës së kryer në A në muajin prill 2010”.

2.4.1 Meqenëse kursimet e subjektit, pra gjendja *cash*, në vitin 2009 kanë qenë në vlerën 1.103.607 lekë, duket se mbulohet investimi prej 200.000 lekësh për blerjen e këtij automjeti. Për këtë arsye, Njësia e Shërbimit Ligjor ka vlerësuar që analiza të paraqitet vjetore, sikurse pasqyrohet në tabelën nr. 7.

Tabela nr.7

Nr.	Përshkrimi	Viti 2010
1	TË ARDHURA	1,679,367
	Të ardhura nga paga subjekti	906,320
	Të ardhura nga paga bashkëshortja	686,887
	Të ardhura nga paga vajza	86,160
2	SHPENZIME	602,004
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	546,480
	Shpenzime TIMS	55,524
3	PASURI	467,336
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Blerje automjeti, datë 12.7.2010	200,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	267,336
	DIFERENCA (1-2-3)	610,027

2.5 Nga analiza financiare e kryer përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të investojë në blerjen e automjetit, si dhe të përballojë të gjitha shpenzimet apo investimet e tjera familjare.

³⁴Kontratë shitje nr. ***, datë 12.7.2010, me palë shitëse M.K dhe palë blerëse Pëllumb Zaimi, të automjetit tip “Mercedes-Benz E250D”, me targa ***, në vlerën 200.000 lekë. Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵Me shkresën nr.*** prot., datë 12.5.2020.

3. Gjendje në llogari rrjedhëse në vlerën 1.101.890 lekë në “Raiffeisen Bank”, në datën 25.1.2017. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga dhe diferenca nga shitja e shtëpisë në Ç, sipas kontratës së shitjes nr.***, datë 26.4.2016. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën vërtetimin nr. *** prot., datë 25.1.2017, të “Raiffeisen Bank”, i cili konfirmon se z. Pëllumb Zaimi ka llogari rrjedhëse në vlerën 1.101.890 lekë.

3.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

3.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr.*** prot., datë 14.5.2020, informon se z. Pëllumb Zaimi ka llogari rrjedhëse me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 1.101.890,09 lekë.

3.3 Pasi Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar dhe ka kryer verifikimet përkatëse, nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e ligjshme për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” nga subjekti i rivlerësimit.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortes së subjektit M.Z

4. Apartament banimi me sipërfaqe 86 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f.***, pallati “****”, ndodhur në ***, Njësia Administrative Dajt, Bashkia Tiranë. Krijuar me kontratë sipërmarrjeje datë 12.6.2007 + kontratë shitjeje nr. ***, datë 31.8.2016, me vlerë 48.700 euro. Burimi i krijimit: të ardhura familjare + të ardhurat nga shitja e apartamentit në Ç me kontratë shitjeje nr. ***, datë 26.4.2016. Vlera: 6.164.870 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Komisioni, në kushtet e kryerjes së hetimit të kësaj pasurie dhe arritjen në konkluzionet përkatëse në deklarinin e subjektit, vlerëson të mos bjerë në përsëritje.

5. Gjendje në llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në datën 25.1.2017. Burimi i krijimit: të ardhura nga ekzekutimi i vendimit nr.***, datë 15.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 28.5.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Vlera: 140.199 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën disa dokumente³⁶.

5.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

5.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr.*** prot., datë 14.5.2020, informon se znj. M.Z ka llogari rrjedhëse me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 140.199,58 lekë.

5.3 Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar dhe kreu verifikimet përkatëse, nuk konstatoi problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e ligjshme për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

Deklarimi i pasurive të vajzës së subjektit O.Z

³⁶Vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, e cila konfirmon se znj. M.Z ka llogari rrjedhëse në vlerën 140.199 lekë; vërtetim nr. *** prot., datë 18.1.2017, nga përmbartuesi privat “A.GJ”, e cila konfirmon se znj. M.Z ka përfituar shumën 388.200 lekë nga pala debitore Prefektura Berat; kërkesë për transaksion në datën 5.11.2015, në BKT, në vlerën 167.000 lekë; kërkesë për transaksion në datën 14.9.2015, në BKT, në vlerën 190.000 lekë; faturë tatimore nr.***, datë 2.12.2015, në emër të znj. M.Z, në vlerën 31.200 lekë, si shërbime përmbartimi; vendim nr. ***, datë 15.10.2014, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me palë paditëse M.Z dhe palë të paditur Prefektura e Qarkut Berat, me objekt “zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës”. Gjykata vendosi të detyroje palën e paditur, Prefektura e Qarkut Berat, të dëmshpërblejë me 14 paga vjetore palën paditëse; vendim nr. ***, datë 28.5.2015, nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila vendosi të lërë në fuqi vendimin nr. ***, datë 15.10.2014, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë (aneksnr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

6.Gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në datën 25.1.2017. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga. Vlera: 942 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin³⁷ nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga BKT-ja, e cila konfirmon se O.Z ka llogari bankare në vlerën 942 lekë.

6.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar:Konfirmohet dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

6.2 BKT-ja, me shkresën nr.*** prot., datë 26.5.2020,informon se O.Z ka llogari rrjedhëse me gjendje në datë 26.1.2017, në vlerën 942 lekë.

6.3 Nga verifikimi dhe analizimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e ligjshme për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare rrjedhëse të vajzës së subjektit të rivlerësimit.

Deklarimi i pasurive të djalit të subjektit R.Z

7.Gjendje në llogari rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”, në datën 25.1.2017. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga *neto* në shoqërinë “****” sh.p.k. Vlera: 118.200 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin³⁸ datë 24.1.2017, nga “Intesa Sanpaolo Bank”, e cila konfirmon se R.Z ka llogari me balancë në vlerën 118.200 lekë. Pozicioni i përgjithshëm i klientit R.Z.

7.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

7.2“Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr.*** prot., datë 19.5.2020,informon se R.Z ka llogari rrjedhëse me gjendje në datën 26.1.2017, në vlerën 118.200 lekë.

7.3 Nga verifikimi dhe analizimi i të dhënave në dokumentacionin e administruar, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me deklaratimet dhe burimet e ligjshme për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare rrjedhëse të djalit të subjektit të rivlerësimit në “Intesa Sanpaolo Bank”.

Gjetje të tjera

8. Komisioni hetoi duke kryer verifikimet përkatëse lidhur me përdorimin e automjeteve, daljet në sistemin *TIMS* me mjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga/dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit. Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike³⁹ AMF, Policia e Shtetit për hyrje-daljet, Ministria e Drejtësisë për administrimin e regjistrimit noterial, nuk kanë rezultuar problematika apo dyshime përveçse atyre të identifikuar gjatë hetimit.

8.1 Komisioni, nën konstatimin se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 vajza e subjektit ka deklaruar adresë tjetër qëndrimi, me përshkrimin “****”, ***, Tiranë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime, i cili, në përgjigjen⁴⁰ e dhënë ka deklaruar se: “*Vajza ka jetuar prej 3 vitesh, gjatë kohës kur ka qenë studente, në banesën e tezes së saj, znj. A.B (Sh) (motra e bashkëshortes time M.Z.SH), e ndodhur në adresën që ju i referoheni*”.

8.2Në mbështetje të deklaratimit, subjekti ka depozituar: deklaratë noteriale nr.***, datë 22.9.2022; certifikatë regjistrimi pasurie të shtetasit A.B; kartelë e pasurisë së paluajtshme;

³⁷Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁸Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁹*E-mail* datë 27.5.2020, nga AMF-ja, protokolluar me nr.*** prot., në dosjen e Komisionit; shkresë nr.*** prot., datë 12.5.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; shkresë *** prot., datë 26.5.2020, nga Ministria e Drejtësisë.

⁴⁰Pyetësor nr.7. datë 19.9.2022.

fragment të hartës kadastrale; deklaratë për përfshirje në legalizim të shtetasit A.B; certifikatë familjare të këtij shtetasi; si dhe certifikatë familjare të subjektit të rivlerësimit.

8.3 Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar dhe ka kreu verifikimet përkatëse, nuk konstatoi problematika dhe as ngriti dyshime për ekzistencën e kësaj pasurie.

9. Komisioni, nisur nga një konstatim i ILDKPKI-së, e cila në raportin e saj ka parashtruar se nga ana e subjektit nuk është deklaruar në deklaratat e interesave private ndër vite dhe në deklaratën e pasurisë *Vetting* pjesa takuese 1/6 e 1/5 pjesënga trashëgimia e apartamentit me sip. 62 m², në Ç, përfituar nga privatizimi, hetoi mbi këtë çështje dhe nxori në pah këto fakte.

9.1 ZQRPP-ja Tiranë, me shkresat nr. *** prot., datë 10.8.2017 dhe datë 9.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Skrapar, e cila konfirmon se z. Pëllumb Zaimi ka përfituar nga dëshmia e trashëgimisë së babait 1/6 e 1/5 pjesë të pasurisë së llojit apartament me sip. 62 m², me nr. ***. Pasuria është përfituar nga privatizimi i banesave.

9.2 Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga dëshmia e trashëgimisë së babait 1/6 e 1/2 pjesë të pasurisë së llojit ndërtesë me sip. 27m², me nr. ***, truall shtet, i papaguar. Për këtë pasuri bashkëlidhur është administruar dokumentacioni përkatës. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë për pjesën takuese për këtë pasuri, me deklaratën noteriale nr.***, datë 19.6.2006.

9.3 Sipas vendimit nr. ***, datë 3.4.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Skrapar, me objekt “çeljen e trashëgimisë ligjore pas vdekjes së F.Z”, trashëgimtarët ligjorë përfitojnë 1/6 pjesë të pasurisë së trashëguar.

9.4 Bazuar në deklaratën noteriale⁴¹ nr. ***, datë 19.6.2006, konstatohet se deklaruesi, subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, dhe shtetasi B.Z (vëllai i subjektit) heqin dorë vullnetarisht nga çdo pasuri e luajtshme apo e paluajtshme, e trashëguar nga babai i tyre F.Z.

9.5 ZVRPP-ja Skrapar, me *e-mail*-in datë 4.7.2019, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga dëshmia e trashëgimisë së babait F.Z 1/6 e 1/5 pjesë të pasurisë së llojit apartament me sip. 62 m², me nr. ***. Pasuria është përfituar nga privatizimi i banesave (bashkëlidhur dokumentacioni nr. *** nga privatizimi⁴²).

9.6 Komisioni, në gjendjen faktike dhe ligjore të kësaj çështjeje, në kushtet kur përgjatë hetimit u provua se subjekti i rivlerësimit kishte hequr dorë nga pjesa e tij takuese në pasurinë e trashëguar nga babai i tij F.Z, nuk evidentoi ndonjë problematikë.

10. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, përveç të ardhurave të përfituara nga punësimi, ka deklaruar edhe të ardhura të tjera, si: (a) të ardhura nga interesat e huadhënies ndaj shoqërisë “****”sh.p.k. me president K.S: kontratë huadhënie datë 24.5.1994, në shumën 500.000 dhrahmi; aktmarrëveshje datë 2.2.1995, për shtyrje afati, shtyrje kontrate datë 18.7.1995, për shtyrje afati, kontratë datë 22.9.1994, në shumën 625.000 dhrahmi, si dhe shtyrjen e kësaj kontrate në datën 18.7.1995; interesat e fituara nga të dyja kontratat e huadhënies janë në shumën 171.875 lekë; (b) të ardhurat e përfituara nga depozitimi i mjeteve monetare në fondacionin “****” në datën 4.12.1996, në shumën 30.000 lekë, përfituar interesat datë 15.5.1997, në shumën 66.000 lekë.

Trupi gjykues, në kushtet kur konstatoi se për të ardhurat nga interesat nuk provohet të jetë paguar tatim në burim, por edhe për faktin që për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk i ka përdorur si burim për asnjë nga pasuritë e tij, nuk i përfshiu ato në analizën financiare.

⁴¹Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴²Aneks nr.*** në dosjen e ILDKPKI-së.

11. Në deklaratën periodike të vitit 2008, subjekti ka deklaruar dorëzimin e bonove të privatizimit për vitin 1994, në shumën 75.000 lekë (të cilat përbëjnë 0.00041% të kapitalit në A), në Degën e Thesarit S, për t'u bërë aksioner në A.

11.1 Komisioni i ka kërkuar⁴³subjektit sqarime mbi këtë veprim, si dhe informacion mbi statusin aktual të këtyre aksioneve. Subjekti ka deklaruar: *“Në datën 10.1.2008 kam dorëzuar bonot e mia të privatizimit në shumën 75.000 lekë në Degën e Thesarit S, për blerje aksionesh në A sh.a., për shkak se bashkëshortja ime M.Z ka qenë punonjëse e A sh.a. Skrapar dhe i kishte lindur e drejta për t'u bërë aksionere në këtë shoqëri. Nuk kam dijeni as unë dhe as bashkëshortja ime M.Z për statusin aktual të këtij veprimi, si dhe deklaroj se nuk kam përfituar dividend nga A sh.a.”*

11.2 Subjekti ka depozituar vërtetimin nr.***, datë 19.4.2022, të A, në të cilën konfirmohet fakti i blerjes së aksioneve nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 75.000 lekë dhe nga bashkëshortja e tij në vlerën 50.000 lekë (të cilat përbëjnë 0.00027% të kapitalit në A), si dhe fakti që subjekti rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë përfituar dividendë nga kjo shoqëri, pasi Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “A” nuk ka shpërndarë dividendë nga momenti i fitimit të titullit të pronësisë deri datën e këtij vërtetimi.

11.3 Në vijim, Komisioni i kërkoj informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat lidhur me zhvillimin e proceseve gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit me palë ndërgjyqëse shoqërinë “A”

11.4 Gjykata⁴⁴ ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, përgjatë ushtrimit të detyrës, ka zhvilluar 15 procese gjyqësore me këtë palë ndërgjyqëse prej vitit 2014 e në vijim dhe gjithashtu edhe katër procese të tjera prej vitit 1999 deri në vitin 2002. Nga informacioni i dhënë vërehet se objekti i padisë ka qenë kryesisht “lëshim i urdhrit të ekzekutimit” apo “përmbushje e detyrimit kontraktor” ndaj kësaj shoqërie nga subjekte të ndryshëm. Në këto rrethana, Komisioni ka vërejtur se nisur nga fakti që subjekti ka deklaruar se bonot e privatizimit janë depozituar pranë shoqërisë “A” në vitin 2008, konfirmuar kjo edhe nga dokumentacioni i administruar nga kjo shoqëri⁴⁵, çështjet e gjykuara përpara këtij viti nuk bëhen pjesë e kësaj çështjeje, objekt i këtij hetimi administrativ.

11.5 Gjithashtu, Komisioni i kërkoj⁴⁶ informacion APP-së për të konfirmuar: (a) nëse shoqëria ku subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë dorëzuar bonot e privatizimit është shpallur ndonjëherë fituese dhe, nëse po; (b) sa ka qenë numri i kontratave të lidhura me institucione të ndryshme; (c) nëse janë bashkëshortët të regjistruar në sistemin elektronik (SPE); dhe (ç) nëse kanë marrë ndonjëherë pjesë në procedurë prokurimi elektronik.

11.6 Agjencia e Prokurimit Publik, në informacionin e saj, ka konfirmuar se:(a) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk janë të regjistruar në sistemin elektronik (SPE) dhe, për pasojë, nuk kanë marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi elektronik; (b) shoqëria “A” rezulton e regjistruar në SPE, ka marrë pjesë dhe është shpallur fituese në 443 procedura prokurimi.

11.7 Komisioni, mbi rrethanat faktike të kësaj çështjeje, ka vërejtur se ato nuk përlligjen me dispozitat ligjore të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe konkretisht në pikën 1 të nenit 21, ku parashikohet se: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës*

⁴³Pyetësor nr.2, datë 7.4.2022.

⁴⁴Me shkresën nr.*** prot., datë 31.8.2022.

⁴⁵Shihni dokumentacionin shoqërues të pyetësorit nr.2, datë 7.4.2022.

⁴⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 30.6.2022.

së shkallës së parë e në atë të apelit dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasi, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.

11.8 Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, për sa i takon kësaj çështjeje, Komisioni⁴⁷ i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe për të provuar me dokumentacion, pasi dukej se:(i) subjekti i rivlerësimit është në shkelje të këtij parashikimi ligjor në raport me ushtrimin e funksionit të tij, për shkak të zotërimit të aksioneve në këtë shoqëri;(ii) bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, dukej se subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, për faktin se ka gjykuar çështje të kësaj shoqërie, duke qenë njëkohësisht edhe aksioner i saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11.9Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ndër të tjera lidhur me këtë çështje, ka analizuar çështjet e gjykuara prej tij si gjyqtar me palë A, dhe ka qartësuar përfundimin e tyre së bashku me pasojat e sjella, si p.sh. në rastet e pushimit, për të cilat ka theksuar se vendimmarrjet nuk sjellin pasoja për palët në proces apo edhe për rastet e tjera të gjykuara të cilat kanë përfunduar me vendime të formës së prerë.

11.10 Subjekti ka referuar vendimin nr.***, datë 23.11.2021, të Kolegjit, duke theksuar se vendimi interpreton dhe sqaron në mënyrë të detajuar *se nuk jemi para rastit të konflikt të interesit edhe kur subjekti është aksioner në një shoqëri, në rastin konkret në A sh.a. Vlera e këtyre aksioneve është e papërfillshme, minimaliste (de minimis).*

Subjekti, duke iu referuar këtij vendimi, ka cituar se në rastin e tij, ai dhe bashkëshortja M.Z janë bërë aksionerë në vlerën 0.00027% të aksioneve të A, për shkak se znj. Zaimi ka qenë punonjëse e A në momentin e privatizimit të kësaj shoqërie.

11.11 Subjekti ka deklaruar se që nga koha e dorëzimit të këtyre bonove të privatizimit dhe deri më sot, ai dhe bashkëshortja e tij nuk kanë asnjë lloj informacioni dhe asnjë lloj dijenie për shndërrimin e bonove të privatizimit në aksione të shoqërisë.

11.12 Subjekti ka ritheksuar se shoqëria nuk ka shpërndarë dividend për asnjë nga aksionerët (ish-punonjësit).

11.13 Po ashtu,subjekti i është referuar edhe Komentarin të Parimeve të Bangalores, më konkretisht, pikës 52 lidhur me parimin e paanshmërisë si *cilësia themelore e kërkuar nga një gjyqtar...*, si dhe pikës 68 të tij lidhur *medetyrën për të zvogëluar konfliktet e interesit që rrjedhin nga aktiviteti financiar, ku ndër të tjera thuhet se ... gjyqtari duhet të jetë i vetëdijshëm që publiku mund ta shohë pronësinë e aksioneve si një interes skualifikues. Sidoqoftë, gjykatësi nuk duhet të përdorë aksione de minimis padyshim si një mjet për të shmangur gjykimin e çështjeve.*

Subjekti ka deklaruar: *“...sipas parashikimeve në Komentarin e Parimeve të Bangalores, rrethanave faktike në të cilat ndodhem, unë subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, lidhur me aksionet që disponojmë në masën 0,00027% në A sh.a. konsiderohet të jetë një interes ‘de minimis’, që nuk kërkon përjashtimin e një gjyqtari në një çështje që përfshin atë korporatë, pronësia e thjeshtë deri në 1%.*

Gjithashtu, sipas këtij parashikimi të Komentarit, gjyqtari nuk duhet ta shohë pronësinë si një interes skualifikues për të shmangur gjykimin e çështjeve, pasi interesi konsiderohet aq minimalist, saqë nuk mund të ketë ndikim në paanësinë e gjyqtarit në gjykimin e çështjes”.

⁴⁷Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

11.14Subjekti ka referuar edhe ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku aksionerët që përbëjnë më pak se 5% të aksioneve nuk kanë të drejtë vote, madje nuk kanë të drejtë të ngrenë as padi për të kundërshtuar vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë. Subjekti ka depozituar dokumentacionin mbështetës, mbi të cilin edhe ka argumentuar gjetjet e Komisionit⁴⁸.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

11.15 Trupi gjykues në këtë çështje objekt vlerësimi, vëren se referimi i subjektit në pikën 52 të Komentarit të Parimeve të Bangalores duhet të shihet në harmoni edhe me pikën 68të këtij dokumenti, ku specifikisht citohet: *“Detyra për të zvogëluar konfliktet e interesit që rrjedhin nga aktiviteti financiar, ku parashikohet: Në mënyrë të ngjashme, një gjyqtar nuk duhet të lejojë që aktivitetet e tij financiare të ndërhyjnë në detyrën për të kryesuar çështjet që vijnë para gjykatës. Megjithëse disa përjashtime do të jenë të pashmangshme, një gjyqtar duhet të reduktojë konfliktet e panevojshme të interesit që lindin kur gjyqtari ruan interesa financiare në organizata dhe subjekte të tjera që paraqiten rregullisht në gjykatë, duke hequr dorë nga këto interesa. Për shembull, aksionet në pronësi të një gjyqtari mund të jenë të një rëndësie të tillë për të, pavarësisht nga vlera e tij de minimis kur shihet në dritën e madhësisë së korporatës, ai përjashtim është i garantuar. Po kështu, gjyqtari duhet të jetë i vetëdijshëm që publiku mund ta shohë pronësinë e aksioneve si një interes skualifikues. Sidoqoftë, gjykatësi nuk duhet të përdorë aksione de minimis padyshim si një mjet për të shmangur gjykimin e çështjeve”*.

11.16 Trupi gjykues çmon se në rrethanat faktike të kësaj çështjeje, në raport me parimin se subjekti i rivlerësimit përmes veprimeve, mosveprimeve apo vendimmarrjes së tij, nuk mund të krijojë përfitime apo avantazhe për vete, familjarët, të afërmit apo personat e tjerë fizikë dhe juridikë, me të cilët ndan interesa ekonomike ose politike, në rastin konkret, duket sikur ka konflikt interesi, por nga ana tjetër, sipas parashikimeve në Komentarin e Parimeve të Bangalores, rrethanave faktike në të cilat ndodhet subjekti i rivlerësimit lidhur me aksionet që disponon në masën 0,00027% të kapitalit të A, konsiderohet të jetë një interes *de minimis* që nuk kërkon përjashtimin e një gjyqtari në një çështje që përfshin në atë korporatë pronësinë e thjeshtë deri në 1%. Gjithashtu, sipas këtij parashikimi të Komentarit, gjyqtari nuk duhet ta shohë pronësinë si një interes skualifikues për të shmangur gjykimin e çështjeve, pasi interesi konsiderohet aq minimalist, saqë nuk mund të ketë ndikim në paanësinë⁴⁹ e gjyqtarit në gjykimin e çështjes.

11.17 Në përfundim, trupi gjykues çmon se ndërkohë që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë zotëruar aksione pranë kësaj shoqërie, duket se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 72, pika 1 dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, por kjo shkelje nuk ka qenë në një nivel të tillë që mund të kualifikohet brenda

⁴⁸Shkresë nr.*** prot., datë 14.4.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; shkresë nr.*** prot., datë 19.4.2022, e A; shkresë nr.*** prot., datë 15.4.2022 (tabelat e periudhës 2000 – 2012), e DRSH-së Berat; vendim nr.***, datë 5.7.2004, i A; vendim nr.***, datë 13.12.2004, i A; vendim nr.***, datë 5.4.2005, i A; vendim nr.***, datë 11.12.2000, i A; vendim nr.***, datë 30.5.2006, i A; kontratë kolektive e punës nr.*** prot., datë 12.11.2010, e shoqërisë dhe A; vendim civil nr.***, datë 13.1.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 29.1.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 20.2.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 8.9.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil datë 8.9.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 27.4.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 19.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil datë 4.6.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 10.3.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 4.4.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 9.4.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 9.4.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 19.4.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 23.5.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 27.5.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; vendim civil nr.***, datë 27.5.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁴⁹Referuar edhe vendimit nr.***, datë 23.11.2021, të Kolegjit.

përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pikërisht duke konsideruar parashikimet në Komentarin e Bangalores apo e vlerësuar kjo edhe në funksion të përfundimit të këtyre çështjeve me vendim të formës së prerë dhe interesit minimalist, pasi në rrethanat faktike nuk rezulton të ketë asnjë pasojë nga veprimtaria e ushtruar nga subjekti në lidhje me shoqërinë, sa i takon zhvillimit të gjykimeve.

B. KONTROLLI I FIGURËS

a. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës⁵⁰, me nr.*** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr.***, datë 9.5.2022, të KDZH-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-jaka konstatuar:Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi.

Hetimi i Komisionit

b. Komisioni i ka kërkuar⁵¹ DSIK-së përditësimin e raportit të dërguar.

i) Ndër të tjera, në raport thuhet: Gjatë periudhës në të cilën z.Zaimi ushtronte detyrën si gjyqtar dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Bazuar në nenin 38 të ligjit nr.84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në këtë rast në cilësinë e gjyqtarit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin në përmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik, apo për persona të lidhur me të duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësojmë se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.

ii) Në përfundim, grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi.

iii) Komisioni, pas njohjes me raportin e DSIK-së, kërkoi dhe administroi fashikujt penalë të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit. Nga shqyrtimi i këtyre çështjevevërehet se ato paraqesin elemente, të cilët përbëjnë *indicie* për subjektin e rivlerësimit, për sa i përket kriterit profesional dhe, për rrjedhojë, trajtimi i saj paraqitet në rubrikën “Gjetje të tjera” të seksionit “Vlerësimi profesional”.

iv)Në funksion të informacionit të dhënë nga DSIK-ja në raportin e deklasifikuar pjesërisht, ku citohet *seinstitucionet verifikuese kanë informuar instancat kompetente Prokurorinë e Krimeve të Rënda me materiale mbi dyshime për veprimtari të kundërligjshme, për trajtimin dhe shqyrtimin e rasteve të tilla*, Komisioni i ka kërkuar SPAK-ut informacion dhe

⁵⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2022.

⁵¹Me shkresat nr.*** prot., datë 11.4.2022 dhe nr.*** prot., datë 20.4.2022.

dokumentacion nëse në adresë së subjektit të rivlerësimit është depozituar/trajtuar procedim penal apo material kallëzues.

v) SPAK-u⁵² ka informuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është depozituar materiali kallëzues, me kallëzues shtetasin LL.D, i cili është vendosur të dërgohet për vlerësim me shkresën nr.*** prot., datë 24.2.2021, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Sipas kallëzimit⁵³ subjekti akuzohet për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Komisioni ka administruar informacionin dhe dokumentacionin e përcjellë⁵⁴ nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Nga aktet e fashikullit penal rezultoi si vijon:

Për kallëzimin penal nr.*** të vitit 2021, të paraqitur nga shtetasi LL.D, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal”, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

vi) Nga verifikimi përkatës rezultoi se çështja nuk i përket shtetasit LL.D, por djalit të tij R.D, i cili është kallëzuar nga bashkëshortja e tij për dhunë në familje. Nga aktet vërehet se gjatë procesit hetimor bashkëshortja e shtetasit R.D ka kërkuar lirim të bashkëshortit, pasi marrëdhëniet janë normalizuar, si dhe për shkaqe shëndetësore.

vii) Nga aktet konstatohet se nga shtetasi LL.D është depozituar një material i pakuptuar qartësisht nëse është në formën e një kallëzimi, por nga përmbajtja voluminoze vërehen të dhëna të përsëritura, të cilat kryesisht pasqyrojnë pretendime lidhur me vënien në dispozicion të vendimmarrjeve gjyqësore, për të cilat ky shtetas i është drejtuar Drejtuesit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Po ashtu, vërehet se nga prokuroria nuk është trajtuar ndonjë kallëzim i shtetasit LL.D, ndërsa ky i fundit ka marrë përgjigje nga Drejtuesi i Gjykatës lidhur me informacionin e kërkuar. Në përgjigjen e dhënë, ndër të tjera, shtetasit LL.D i është komunikuar mungesa e legjitimitetit për të kërkuar informacion dhe dokumentacion për llogari të djalit të tij, për shkak se ai përfaqësohet me avokat në procesin gjyqësor.

viii) Komisioni, pas analizimit të rrethanave faktike e ligjore për këtë çështje, konstatoi se nuk vërehen *indicie* që përkohet me informacionet e materializuara nga raporti i DSIK-së.

ix) Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konkluzionin e DSIK-së, pasi grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshoi konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri.

x) Subjekti, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka theksuar se: (a) informacioni është i pavërtetë dhe i papajtueshëm me figurën dhe integritetin e tij personal dhe profesional; (b) raporti është dashakeqës, i qëllimshëm, i pabazuar në fakte dhe prova; (c) sipas SPAK-ut nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emrin e tij për periudhën 19.12.2019 deri aktualisht; (ç) pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë nuk rezultoi që të ketë të regjistruar në emrin e tij ndonjë procedim penal për periudhën 1.1.2013 – 18.12.2019. Subjekti, në funksion të shpjegimeve të dhëna, ka depozituar shkresën nr.*** prot., datë 7.10.2022, të SPAK-ut.

xi) Trupi gjykues, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk evidentoi rrethana të cilat mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të

⁵²Me shkresën nr.*** prot., datë 15.4.2022.

⁵³Dërguar nga SPAK-u me shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2021.

⁵⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2022.

mund të cenonin figurën e subjektit, sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) pas analizimit të çështjeve të trajtuara në drejtim të aspektit profesional nuk rezultuan elemente të tilla të qenësishme, që mund të cenonin këtë kriter si më poshtë arsyetohet në konkluzion për këtë kriter – arrin në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së mbeten të paprovuara dhe se konstatimet e vlerësuara në kriterin profesional nuk evidentuan elemente të tilla që mund të meritojnë një vlerësim që cenon këtë kriter apo vlerësimin tërësor të procesit për këtë subjekt. Nën këto konstatime, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Lidhur me analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja

i) Raporti është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga KLGJ-ja me nr.*** prot., datë 16.10.2019, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ii) Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit; tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura; të dhënave e dokumenteve të tjera që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

iii) Nga të dhënat e burimeve arkivore të KLGJ-së ka rezultuar sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Pëllumb Zaimi, në vitin 2014, pranë Inspektoratit të KLD-së, janë paraqitur dy ankesa:

- një ankesë është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor;
- një ankesë është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe i është regjistruar gjyqtarit për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

iv) Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Pëllumb Zaimi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Analiza e gjetjeve në raport pasqyrohet si vijon:

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 prej dokumentave ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, që paraqitet për gjykim. Gjyqtari Pëllumb Zaimi kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile, objekt shqyrtimi gjyqësor. Gjyqtari identifikon rastin kur për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen, duhen njohuri të posaçme, që bëjnë të nevojshëm caktimin e ekspertëve të fushës. Gjyqtari Pëllumb Zaimi ka njohuri në të drejtën penale, ku kombinon rregullat e pjesës së përgjithshme me pjesën e posaçme të Kodit Penal duke realizuar

gjykimin e shkurtuar në çështjet penale. Ai ka njohuri për parimet e përgjithshme të së drejtës dhe i përdor ato në procedurën e gjykimit, siç janë e drejta e mbrojtjes, duke realizuar njoftimin e mbrojtësit si dhe e drejta për t'u paraqitur në gjykatë. Përdor në arsyetim aktet ndërkombëtare, vendime unifikuese, apo praktika gjyqësore.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të kuptueshme. Ai respekton përgjithësisht rregullat e drejtshkkrimit dhe përdor karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Në përgjithësi përdor referenca në parimet apo jurisprudencën e gjykatave më të larta. Gjykatësi i referohet Vendimeve Unifikuese të Gykatës së Lartë, apo praktikës gjyqësore. Gjykatësi i referohet ligjeve të posaçme, kur konstaton se lidhet me objektin e gjykimit, konkretisht i referohet Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për Sigurimin e detyrueshëm”, vendimit unifikues nr. 12, datë 14.09.2007, lidhur me anëtarët pasjetues, Kodit Familjes, si dhe i referohet ligjit 49/2012, “Për Gjykatën Administrative”, në përcaktimin e kompetencës lëndore në rastin e gjykimit të çështjeve me objekt “Pagim dëmi për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës”. Aibën interpretimin e ligjit, i zbaton ato në arsyetimin e vendimit dhe në nxjerrjen e konkluzioneve. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk ka raste që të këtë marrë vendime të ndërmjetme, për të cilat paraqitet ankim i veçantë dhe të jetë i nevojshëm arsyetimi i këtyre vendimeve.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarit Pëllumb Zaimi, ka qenë mbi standardin minimal të përcaktuar. Nw 5-sw dosjet e vëzhguara, është konstatuar se në të gjitha rastet është respektuar afati standard i gjykimit, nuk ka tejkalim të afatit të gjykimit. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se gjykimi i tyre ka zgjatur 7 muaj e 1 ditë, 5 muaj e 12 ditë dhe 3 muaj e 18 ditë. Në të 3 dokumentet ligjore, të paraqitura nga gjyqtari, rezultojnë se gjykimi ka përfunduar brenda afateve standard të Sistemit të Vlerësimit.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Pëllumb Zaimi, i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur, të vendimeve gjyqësore. Vendimet civile janë dorëzuar brenda një afati prej 7 ditësh, duke respektuar afatin ligjor, të përcaktuar në 308/2 të KPC, ku data e dorëzimit të vendimit të arsyetuar, përcaktohet deri në 10 ditë. Vendimet penale janë dorëzuar brenda një afati prej 3 ditësh, duke respektuar afatin ligjor, të përcaktuar në 113 të KPP, ku data e depozitimit të akteve të gjykatës në sekretari, përcaktohet deri në 5 ditë.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, ka respektuar afatin e gjykimit dhe afatin e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

Subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Nga dosjet e vëzhguara rezultojnë se ato janë vënë në lëvizje shpejt, me marrjen e akteve të çështjes me short, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Orari i fillimit dhe i mbarimit të seancës gjyqësore është dokumentuar saktësisht në procesverbal. Nga vëzhgimi i tyre ka rezultuar se është respektuar orari i planifikuar i fillimit të seancës. Në pesë dosjet, nuk ka fillim me vonesë të seancave gjyqësore. Përgjithësisht, gjyqtari Pëllumb Zaimi, ka monitoruar njoftimet e palëve për të shmangur vonesat në dërgimin e tyre apo për

të siguruar zhvillimin korrekt të gjykimit. Fletëthirrjet hartohen menjëherë pas vendimit të caktimit të seancës gjyqësore dhe menjëherë pas përfundimit të seancës gjyqësore, në rastet kur pala nuk ka qënë prezent në gjykim. Gjatë gjykimit, gjyqtari Pëllumb Zaimi, identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe ka operuar me nxjerrjen e urdhërave dhe marrjen e vendime të ndërmjetme. Ai zhvillon dhe dokumenton procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Për çdo kërkesë apo hap procedural, merr rregullisht mendimin e të dyja palëve në gjykim. Disponon me vendime të ndërmjetme për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit, duke paraqitur referencat në nenet përkatëse ligjore procedurale. Aika respektuar të drejtën e palëve për të patur mbrojtës, apo përfaqësues, të cilët janë zgjedhur nga vetë pala.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat, etj. Në çështjet civile ka vendim "Për kalimin e çështjes në seancë përgatitore". Në çështjet penale ka vendim "Mbi kalimin e çështjes në gjykim". Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë.

Nuk ka raste që të jetë konstatuar mungesa e etikës nga ana e gjyqtarit Pëllumb Zaimi.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi, si dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

Për gjyqtarin Pëllumb Zaimi në asnjë rast, prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar çështje të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar as përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Pëllumb Zaimi nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

C/1. Rivlerësimi i aftësisë profesionale

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të miratuar nga KLGJ-ja, dhe kriterete vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (neni 71 e vijues i tij).

Në lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Komisionit, sikurse i ka rezultuar edhe Grupit të Punës në raportin e tij të vlerësimit, në tërësi duket se nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me gjykimin e zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit në të tria dokumentet ligjore, të llojit vendim gjyqësor, si dhe në pesë dosjet gjyqësore të

përzgjedhura me short. Gjithashtu ka rezultuar se në rastet e shqyrtuara nuk ka vendime të cënuara nga gjykatat më të larta.

Çështje të tjera të hetuara në funksion të vlerësimit profesional

1. Komisioni administroi kopjen e dosjes gjyqësore⁵⁵ që i përket të dënuarit L.Q.

Ky shtetas është dënuar nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 23.3.2018, me 9 vjet burgim për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

Gjithashtu, me këtë vendim është dënuar edhe shtetasja A.N, por me 7 vjet burgim për të njëjtën akuzë.

1.1 Me vendimin nr.***, datë 25.11.2019 (të një tjetër subjekti rivlerësimi), shtetasit Q i është ulur dënimi me 90 ditë, pavarësisht kërkesës për ulje dënimi me 270 ditë.

Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 17.12.2021 (kërkesa është regjistruar në datën 25.11.2021, pra gjykimi ka zgjatur tri javë), ka vendosur uljen e dënimit për këtë të dënuar me 90 ditë, për periudhën 10.12.2020-10.12.2021.

1.2 Nga analiza e rrethanave faktike dhe ligjore të kësaj çështjeje, Komisioni ka konstatuar se nga pikëpamja procedurale nuk identifikohen problematika ndaj subjektit të rivlerësimit. Në kontekstin e themelit, ligjshmëria e vendimmarrjes së gjyqtarit është kompetencë e gjykatave më të larta, por që në këtë rast vendimmarrjet janë si rezultat i kërkesave ku institucioni i vuajtjes së dënimit ka prezantuar provat (dinamikën e vuajtjes së dënimit, raport vlerësimi për gjykatë, relacion për vlerësimin e sjelljes për të dënuarin për këtë objekt gjyqësor, kartelë personale, etj.) për të cilat është konkluduar në pranimin e kërkesës.

1.3 Në përfundim, Komisioni nuk evidenton ndonjë mangësi lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, sipas kërkesave ligjore të ligjit nr. 96/2016, që mund të cenojnë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të tij.

2. Komisioni administroi kopjen e dosjes gjyqësore⁵⁶ që i përket të dënuarit E.GJ.

Nga aktet vërehet se ky shtetas është akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal⁵⁷. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të viktimës M.S. Organi i akuzës në diskutimin përfundimtar ka kërkuar dënimin e këtij shtetasi me 4 muaj burgim duke aplikuar më parë edhe gjykimin e shkurtuar⁵⁸.

2.1 Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 17.11.2021, ka vendosur dënimin e shtetasit Gj me 200.000 lekë gjobë në aplikim edhe të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale duke arsyetuar gjithashtu edhe lidhur me anën objektive dhe subjektive të rastit, rrethanat rënduese e lehtësuese (sipas neneve 47 dhe 49 të Kodit Penal), duke caktuar dënimin e tij me gjobë dhe argumentuar gjithashtu se i pandehuri kishte mundësi financiare për të paguar atë.Çështja rezulton e ankimuar nga i pandehuri.

2.2 Komisioni, në pjesën arsyetuese të vendimit nën titullin “*Në seancë gjyqësore u administruan provat e mëposhtme*”, vërejtji se subjekti ka renditur 5 akte dhe në pikën 6 referohet se *janë administruar akte dhe dokumente të tjera shkresore në cilësinë e provave shkresore*.

⁵⁵Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2022.

⁵⁶Dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2022.

⁵⁷Neni 89/Plagosja e lehtë me dashje/Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

⁵⁸Neni 406 vendimi (ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002 dhe me ligjin nr. 145, datë 2.5.2013;... 1. Kur jep vendim dënimi gjykata e ul dënimin me burgim ose gjobë me një të tretën).

2.3 Nga aktet e fashikullit gjyqësor, Komisioni konstatoi se aktet/dokumentet⁵⁹ e renditura në gjashtë pikat e vendimit të arsyetuar, sipas të cilave është bërë arsyetimi, nuk rezultojnë të administruara në dosje dhe, për këtë shkak, i kërkoi subjektit depozitimin e tyre.

2.4 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij mbi rezultatet e hetimit, ka depozituar aktet që përputhen me ato të cituara në arsyetimin e vendimit dhe, njëkohësisht, ka shpjeguar se në rast të gjyqimit të shkurtuar me vendim të ndërmjetëm dosja e seancës paraprake së bashku me procedimin penal i bashkohen dosjes gjyqësore të themelit të çështjes dhe se edhe në këtë rast kështu ka ndodhur.

2.5 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, vëren se: (a) i dënuari nuk ka qenë më parë i dënuar; (b) është sugjeruar nga OPGJ-ja dërgimi i çështjes në gjyq; (c) i është njoftuar të pandehurit pas marrjes në pyetje dhe shpjegimeve të dhëna përfundimi i hetimeve dhe akuza; (ç) sipas raportit mjeko-ligjor i dëmtuari ka rezultuar i paftë për 9 ditë pune; dhe se (d) çështja aktualisht është për gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë mbi ankimin e të dënuarit.

2.6 Për sa më sipër, në përfundim, Komisioni vlerëson se edhe në këtë çështje nuk evidentohen mangësi lidhur me gjykimin e saj, sipas kërkesave ligjore, të ligjit nr. 96/2016, që mund të cenojnë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të tij.

3. Komisioni administroi kopjen e dosjes gjyqësore me të pandehur shtetasin K.S që i përket vendimit nr.***, datë 26.12.2013.

3.1 Nga aktet e administruara rezultoi si vijon: pas referimit të Policisë se ky shtetas kishte kryer aksident me mjetin e tij, i rezultuar në gjendje të dehur, nga ku dhe ishte dëmtuar, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e tij nr.***, datë 26.12.2013, ka vendosur masën e sigurimit personal të detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore ndaj këtij shtetasi, i akuzuar për drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, me objekt vlefësim i arrestit në flagrancë dhe caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

3.2 Nga aktet thuhet se i dyshuari është kapur në kushtet e flagrancës. Ndër të tjera, subjekti ka arsyetuar në vendimin e tij kriteret e nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale duke cituar se *mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara në Kodin Penal...shtetasi S nuk njihet si person me tendencë kriminale dhe nuk rezulton person i dënuar...ai njihet si person punëtor, korrekt në shoqëri dhe me sjellje të mirë.* Vendimi, më tej, është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e saj nr.***, datë 4.2.2014, ka vendosur mospranimin e ankimit të organit të akuzës për shkak të heqjes dorë nga ankimi nga përfaqësuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

3.3 Nga verifikimi i akteve të fashikullit gjyqësor Komisionit nuk i rezultoi i administruar dokumentacioni që provonte gjendjen gjyqësore të të akuzuarit, ashtu sikurse theksohet në vendim se ai ka rezultuar i padënuar dhe, për këtë shkak, i kërkoi subjektit depozitimin e dokumentit, si dhe çdo dokumentacion⁶⁰ tjetër që kishte ndikuar në provueshmërinë e rrethanave lehtësuese.

3.4 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij mbi rezultatet e hetimit, ka shpjeguar se: (a) ndryshimet e Kodit Penal në vitin 2014, konkretisht në nenin 291 të tij, kanë parashikuar drejtimin e automjeteve në gjendje të dehur me burgim 10 ditë deri në tre vjet ose vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit; (b) gjykimi është zhvilluar sipas neneve 259 dhe 244 të Kodit të Procedurës Penale; (c)

⁵⁹Në gjendjen që ndodhëj dokumentacioni i administruar në dosje gjatë hetimit administrativ.

⁶⁰Pasi në gjendjen që janë provat deri aktualisht këto dokumente nuk janë të administruara.

gjykimi është zhvilluar me praninë e prokurorit dhe në dosje janë administruar vetëm provat e përcjella prej tij nëpërmjet fashikullit penal; (ç) subjekti ka shpjeguar se kërkimet e Komisionit janë prova të cilësuar në aktet e fashikullit të organit të akuzës, si p. sh. në vleftësimin e arrestit në flagrancë thuhet se ky shtetas është i padënuar, cilëson gjendjen civile i martuar, etj.; (d) subjekti ka konfirmuar se vendimmarrja e tij ka mbetur në fuqi edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, duke u vendosur mospranim ankimi.

3.5 Në funksion të shpjegimeve të dhëna subjekti ka depozituar aktet e organit të akuzës, si dhe 4 vendime gjyqësore të gjykatave më të larta, të cilat në rast caktimi të masës së sigurimit personal arrest me burg, për të njëjtën akuzë, nga gjykata e shkallës së parë, kanë ndryshuar vendimet në masën e sigurimit personal në “detyrim për paraqitje”.

3.6 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe ligjit të aplikueshëm, vlerëson qëndrimin dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit. Ky vlerësim mbështetet në raport me veprën e kryer, llojin e caktimit të masës së sigurimit personal, faktin që i akuzuari është aksidentuar me mjetin e tij duke shkaktuar pasoja në dëm të tij dhe jo të tretëve, por edhe në raport me vlerësimin e gjykatave më të larta për çështje të së njëjtës natyrë, te të cilat është zëvendësuar masa e sigurimit “detyrim paraqitje” për rastet kur në shkallë të parë është vendosur masa “arrest me burg”.

3.7 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se nuk evidentohen problematika lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016, që mund të cenojnë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të tij.

4. Komisioni administroi kopje të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr.***, datë 8.11.2017.

4.1 Nga aktet e administruara rezultoi se vendimi i dhënë ndaj shtetasit M.S, me cilësinë e kërkuesit (kërkesë penale), ka si objekt uljen e dënimit nga ai i mbetur pa vuajtur, sipas nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, për 90 ditë. Më këtë vendim subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës sipas objektit të kërkuesit (kërkesa e të dënuarit është depozituar në datën 6.10.2017, ndërsa procesi ka zgjatur më pak se një muaj, nga data 12.10.2017 deri më 8.11.2017).

4.2 Rezultoi se ky shtetas, ndër disa të dënuar, është dënuar me vendimin nr.***, datë 12.5.2016, me pesë vjet e katër muaj për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/2 – 22 i Kodit Penal, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e saj nr.***, datë 2.11.2016.

4.3 Sipas vendimit të uljes së dënimit, ulja është pranuar për periudhën 12-mujore të vlerësimit, nga data 2.11.2016 deri në datën 2.11.2017. Sipas arsyetimit të vendimit, ky shtetas nuk ka pasur ulje të mëparshme. Në dosje është administruar dinamika e vuajtjes së dënimit, vlerësim sjellje për të dënuarin për këtë objekt gjyqësor, kartelë personale e të dënuarit, etj.

4.4 Komisioni konstaton se ligji i aplikueshëm mbi të cilin është bazuar vendimmarrja ndaj të dënuarit rezulton neni 63 i ligjit të lartpërmendur, i cili ka parashikuar:

Ulja e dënimit (ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008): “Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e

mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit. Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit apo përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit”.

4.5 Komisioni konstaton se në gjendjen faktike dhe ligjore të kësaj çështjeje, për aq sa ka kompetencë, nuk evidenton mangësi apo elemente të tilla që cenojnë kriterin profesional. Rezulton se bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar në vendim subjekti ka saktësuar faktin se vuajtja e dënimit do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

5. Komisioni administroi dosjen gjyqësore që i përket vendimit nr.***, datë 9.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Vendimi i referohet kërkesës penale të organit të akuzës, kundër të pandehurës M.J, akuzuar për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur dënimi i kësaj shtetaseje me 4 muaj burg në zbatim edhe të aplikimit të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 28.5.2015.

5.1 Komisioni, nga verifikimi i akteve të administruara në dosje, ka vërejtur se çështja rezulton të jetë regjistruar në datën 2.5.2014 dhe përfunduar në datën 9.6.2014. Pra, gjykimi ka zgjatur vetëm një muaj e 7 ditë. Organi i akuzës ka kërkuar dënimin e kësaj shtetaseje me 6 muaj burgim, uljen e dënimit me 1/3 e tij, si dhe aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke e vënë në provë për dy vjet.

Në përfundim, Komisioni nuk ka konstatuar parregullsi të natyrës procedurale, të cilat janë kompetencë verifikimi nga Komisioni.

6. Komisioni administroi dosjen që i përket vendimit nr.***, datë 10.12.2019, të personit nën hetim, shtetasit S.T.

6.1 Komisionit, nga aktet e dosjes (sipas vendimit gjyqësor të dhënë nga subjekti i rivlerësimit), i ka rezultuar se ndaj këtij shtetasi është regjistruar procedimi penal nr.***, datë 31.10.2018, për veprën penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal, mbi bazë të materialit të DVP-së Berat. Regjistrimi i procedimit penal është bërë mbi kallëzimin e shtetasit Q.K, i cili prej një viti kishte tërhequr pensionin e pleqërisë nga filiali “Posta Shqiptare”, zyra ***, nga punonjësi S.T. Për një periudhë ai nuk e kishte tërhequr pensionin dhe kur ishte interesuar pranë zyrës postës për të tërhequr lekët e muajve të patërhequr, ka mësuar se shuma ishte tërhequr nga dikush, ndërsa punonjësi T ishte larguar nga puna. Më pas, viktimë është takuar me shtetasin T, i cili i kishte premtuar se do t’ia kthente shumën, por në fakt ai është larguar nga vendi dhe në të tilla kushte shtetasi Q.K ka bërë kallëzimin përkatës.

6.2 Përgjatë gjykimit është konstatuar se personi nën hetim është dënuar më parë për të njëjtin fakt penal me vendimin e formës së prerë nr. ***, datë 26.6.2019, me katër muaj burgim duke u aplikuar ndaj tij edhe neni 59 i Kodit Penal, pasi ndaj tij ishte regjistruar procedimi penal nr.***, datë 10.10.2018, mbi kallëzimin e filialit të Postës Shqiptare, për vjedhje të pensionit të shtetasit K. Kërkuesi, përfaqësuesi i organit të akuzës, i cili ka vënë në lëvizje gjykatën në këtë proces gjyqësor, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr.***, datë 31.10.2018, kërkesë me të cilën është dakordësuar edhe personi nën hetim dhe, po ashtu, edhe viktimë. Në të tilla kushte është vendosur pranimi i kërkesës së përfaqësuesit të organit të akuzës dhe, për pasojë, është vendosur pushimi i çështjes, vendim i cili rezulton të jetë i formës së prerë.

6.3 Komisioni, në kushtet e vërejtura se parashtrimi i çështjes më sipër i referohej thjesht dhe vetëm arsyetimit të vendimit gjyqësor dhënë nga subjekti, i kërkoi këtij të fundit të depozitonte vendimin gjyqësor nr. ***, datë 26.9.2019, si dhe kërkesën/përmbajtjen e saj e përfaqësuesit të organit të akuzës.

6.4 Subjekti, përmes parashtrimeve të tij, depozitoi vendimin gjyqësor nr. ***, datë 26.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, si dhe kërkesën e organit të akuzës për pushimin e procedimit penal objekt i këtij hetimi.

6.5 Nga aktet e administruara konfirmohet kërkesa e organit të akuzës drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat në gjykimin e çështjes nga subjekti i rivlerësimit për pushimin e çështjes, për shkak se më parë nga kjo gjykatë ishte deklaruar fajtor dhe ishte dënuar shtetasi T, me katër muaj burgim, me vendimin nr. ***, datë 26.9.2019, duke e vënë në provë për tetë muaj me qëllim moskryerjen e ndonjë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës, Zyra Vendore Berat.

6.6 Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë faktike e ligjore që mund të cenojë kriterin profesional apo procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

C/2.Mbi denoncimet e depozituara në Komision për subjektin e rivlerësimit

Në lidhje me njëzet e pesë denoncimet e paraqitura⁶¹ për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pas shqyrtimit të ankimeve, provave të depozituara nga denoncuesit, si dhe dosjeve të kërkuara dhe administruara rast pas rasti, për shtatë denoncime konkludoi paraprakisht në disa konstatime, për të cilat i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe depozitohet dokumentacion mbështetës. Më konkretisht, lidhur me hetimin e kryer për këtë kategori të çështjes, ka rezultuar si vijon:

1.Denoncim⁶² i Dhomës së Avokatëve ***

1.1 Denoncuesi, i cili është i paidentifikuar, ndër pretendime të shumta për të tjerë subjekte rivlerësimi, pretendon për nepotizëm të subjektit Zaimi, në ushtrimin e detyrës, me studion ligjore “***”, si dhe hedh akuza të rënda për dhëndrin e subjektit të rivlerësimit pa prezantuar identitetin e tij.

1.2 Komisioni, fillimisht, pasi verifikoi statusin e studios “***” në QKB, konstatoi se ajo është regjistruar me person fizik djalin e subjektit R.Z, në vitin 2019, me NIPT ***. Më tej, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat informacion nëse subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës ka gjykuar çështje me/ndaj këtë studio ose me pjesëmarrjen e kësaj studioje në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, nga ku nuk është konfirmuar⁶³ ndonjë rast i tillë. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka konfirmuar⁶⁴ se kjo studio ligjore, prej fillësës së saj dhe deri aktualisht, ka përfaqësuar 127 çështje nga 9.905, rreth 1.28%, të gjykuara prej gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019 deri më gjashtëmujorin e parë të vitit 2022.

1.3 Në lidhje me pretendimin tjetër të denoncuesit, Komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Policisë së Shtetit⁶⁵ (sektorit të marrëdhënieve ndërkombëtare) për të konfirmuar të dhëna (mbi çështje të trafikut të drogës) në adresë të shtetasit A.A (bashkëjetuesi i vajzës së subjektit të rivlerësimit), nga ku⁶⁶ nuk janë konfirmuar të dhëna të kësaj natyre.

1.4 Gjithashtu, lidhur me këtë çështje, Komisioni ka mbajtur korrespondencë me SPAK-un, nga ku konfirmohet⁶⁷ se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimeve të veprave penale të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë, nuk rezulton që në emër të shtetasit A.I.A të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

⁶¹Ku tetë denoncues kanë ripërsëritur denoncimin duke u ankuar për të njëjtin objekt ankimi.

⁶²Nr. *** prot., datë 20.11.2019.

⁶³Sipas përgjigjes së dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2022.

⁶⁴Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 26.5.2022.

⁶⁶Me shkresën e nivelit “sekret”.

⁶⁷Me shkresën nr.*** prot., datë 17.8.2022.

1.5 Për sa më sipër konstatuar, Komisioni konkludon se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë dhe, për pasojë, ato nuk ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit.

2.Denoncim⁶⁸ i shtetasit F.SH

2.1 Denoncuesi ankohet për keqpërdorim të nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile nga subjekti i rivlerësimit për vendimin nr.***, datë 16.11.2016, dhënë prej tij, për shkak se është ekzekutuar tërësisht.

2.2 Denoncuesi ka depozituar disa dokumente.

2.3 Sipas vendimit nr.***, datë 16.11.2016, të subjektit të rivlerësimit, ku denoncuesi është me cilësinë e palës së paditur nga paditësi K.B, me objekt gjyqësor *pushim cenimi të servitutit të kalimit*, rezulton se është vendosur pranimi i padisë. Ky vendim rezulton të jetë lënë në fuqi nga vendimi nr. ***, datë 11.10.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë. Më tej, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 15.10.2019, ka vendosur sqarimin dhe interpretimin e vendimit të themelit. Pretendimi i denoncuesit se kjo vendimmarrje ka ardhur pas ekzekutimit të vendimit të themelit duket se nuk qëndron, pasi duke iu referuar dokumentacionit të depozituar nga vetë denoncuesi vërehet se ekzekutimi i vendimit të themelit është ekzekutuar forcërisht dhe në procesverbalin e nënshkruar nga palët me përjashtim të refuzimit të bërë nga pala e paditur, identifikohet pikërisht nevoja e interpretimit të vendimit të themelit për njërën nga pikat e dispozitivit, për të cilën pala paditëse ka deklaruar se do t'i drejtohet gjykatës dhe në fakt ashtu ka ndodhur. Paditësi ka vënë në lëvizje gjykatën me objekt, *saktësim dhe interpretim i vendimit të themelit*, nga verifikimi i të cilit provohet se kërkimi është regjistruar në datën 12.7.2019, kohë kur edhe ishte kryer ekzekutimi pjesor i vendimit të themelit.

2.4 Për sa më sipër argumentuar, Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit.

3.Denoncim⁶⁹ i shtetasit B.M (bashkim i dy denoncimeve)

3.1 Denoncuesi i është drejtuar organit të akuzës për konflikte pronësore të ndodhura me të tretë, nën pretendime për cenim dhe zaptim të pasurisë së tij, fituar me ligjin nr.7501, për të cilën është vendosur në datën 14.2.2020, “Mosfillim i procedimit penal”. Më tej, sqaron se i është drejtuar gjykatës me ankim ndaj vendimit të mosfillimit dhe se çështja ka nisur shqyrtimin e saj nga subjekti i rivlerësimit. Denoncuesi sqaron se ka kërkuar përjashtimin e subjektit nga kjo çështje, por nuk identifikon shkelje konkrete. Më tej, ankohet për shkelje të etikës nga subjekti dhe për këtë ka pasqyruar në denoncim një komunikim të shkurtër mes palës ndërgjyqëse dhe subjektit për të provuar shkeljen e pretenduar.

3.2 Komisioni, për shqyrtimin e këtij denoncimi, ka administruar⁷⁰ kopje të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 17.7.2020, të subjektit të rivlerësimit, si dhe kopje të CD-së përkatëse.

3.3 Nga aktet e administruara rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet procedurale, si caktimin e seancave gjyqësore, njoftimet përkatëse të palëve, si dhe janë administruar procesverbalet e seancave gjyqësore. Çështja gjyqësore është pezulluar për një kohë, për shkak të zbatimit të VKM-së nr. 127, datë 10.3.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë së shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” lidhur me situatën e pandemisë. Ky veprim konfirmohet sipas procesverbalit datë 17.3.2020 “Për mosçelje të seancës gjyqësore”. Çështja gjyqësore është regjistruar në datën 3.3.2020 dhe ka përfunduar

⁶⁸Nr. *** prot., datë 24.6.2020.

⁶⁹Me e-mail datë 2.7.2020 dhe nr. *** prot., datë 3.7.2020.

⁷⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

në datën 17.7.2020. Vendimi i subjektit të rivlerësimit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, pasi kjo e fundit me vendimin nr.***, datë 18.3.2021, ka vendosur mospranimin e ankimit.

3.4 Sa i përket pretendimit të denoncuesit për shkelje të etikës nga subjekti në komunikim, Komisioni, nga dëgjesa e bërë CD-së, ndër të tjera, ka konstatuar hera-herës shprehje drejtuar palës ndërgjyqëse, të cilat duken joetike për figurën e magjistratit⁷¹.

3.5 Për sa më sipër, Komisioni⁷² i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe depozitohë dokumentacion, pasi dukej se shprehjet drejtuar palës ndërgjyqëse përgjatë komunikimit janë joetike për figurën e magjistratit dhe cenojnë parimet e përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore (parimin e integritetit, sjelljes së hijshme dhe vetëpërmbytjes, respektit dhe aftësisë për të dëgjuar, etj.), miratuar me vendimin nr. ***, datë 22.4.2021, të KLGJ-së.

3.6Subjekti, në parashtrimet e tij, ka kundërshtuar pretendimet e denoncuesit dhe ka sqaruar se: (i) çështja është zhvilluar në dy seanca; (ii) është bërë verifikimi i prezencës së palëve dhe është kërkuar identifikimi me mjetin përkatës; (iii) babai i denoncuesit, i cili ka vënë në lëvizje gjykatën me ankim ndaj mosfillimit të vendimit, shtetasi Q.M, është paraqitur pa mjet identifikimi; (iv) ka shpjeguar kuptimin gjuhësor të shprehjeve të përdorura; (v) denoncuesi ka marrë pjesë në seancë dhe ka ndërhyrë disa herë duke përdorur fjalë dhe kryer veprime duke folur në telefon; (vi) nëpërmjet punonjësit të sigurisë ka kërkuar urdhërimin e daljes nga seanca të shtetasit B.M; (vii) në një moment që është hapur dera e sallës së gjyqit ku zhvillohej seanca ai ka qenë me kurriz dhe ka pyetur sekretaren gjyqësore që për shkak të pozicionit të saj, ajo mund të shihte se kush kishte hapur derën dhe pasi ka marrë përgjigjen prej saj, është shprehur për personin që ka hapur derën pa trokitur, i cili prishte qetësinë në gjykim. Në përfundim, subjekti ka theksuar se shprehjet e përdorura prej tij nuk përbëjnë shkelje të etikës së figurës së magjistratit dhe, njëkohësisht, ka qartësuar edhe statusin e çështjes, për të cilën është vendosur rrëzimi i kërkesës dhe më tej nuk është pranuar ankimi. Subjekti ka depozituar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat⁷³, vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë⁷⁴, si dhe procesverbale të seancave gjyqësore⁷⁵.

3.7 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të dhëna nga subjekti në tërësi, vëren se subjekti nga njëra anë ka pranuar përdorimin e disa shprehjeve jo të duhura por nga ana tjetër ka qartësuar edhe kuptimin e tyre duke pretenduar se shprehjet nuk i janë adresuar palëve në gjykim, porse ato janë drejtuar në një moment të caktuar për shkak të mosruajtjes së qetësisë nga palët në gjykim. Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë faktin e përdorimit të shprehjeve jo të duhura gjatë ushtrimit të detyrës ku kërkohet solemnitet dhe në raport me vendin e përdorimit të tyre, çmon se subjekti, si magjistrat në sistemin e drejtësisë, duhet të evitohë çdo fjalor joetik, pavarësisht situatës që e dikton atë. Në konkluzion, trupi gjykues, në raport me shpjegimet e subjektit mbi rrethanën që i ka përdorur këto shprehje, vlerëson se kjo mangësi, duke qenë një rast i veçuar në veprimtarinë e punës së subjektit, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut të qenësishëm për penalizim të tij. Ndërsa, lidhur me ankimin e denoncuesit mbi themelin e çështjes, Komisioni, nga verifikimi i akteve të administruara vëren se palët, ankues - i kallëzuar, kanë normalizuar marrëdhëniet dhe për këtë shkak nga Gjykata e Apelit Vlorë është vendosur mospranimi i ankimit.

⁷¹Referuar parimeve të përcaktuara në Kodin e Etikës Gjyqësore (parimit të integritetit, sjelljes së hijshme dhe vetëpërmbytjes, respektit dhe aftësisë për të dëgjuar, etj.), miratuar me vendimin nr. ***, datë 22.4.2021, të KLGJ-së.

⁷²Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁷³Nr. *** prot, datë 17.7.2020.

⁷⁴Nr. *** prot, datë 18.3.2021.

⁷⁵Datat 2.7.2020 dhe 17.7.2020.

4. Denoncim⁷⁶ i shtetasit K.L

4.1 Denoncuesi i përfaqësuar me prokurë nga shtetasi R.N në ankimin e tij drejtuar Komisionit, por edhe instancave të tjera kërkon të pasqyrojë faktin se ankesa e tij është e ripërsëritur në drejtim të kërimit për përjashtim të subjektit të rivlerësimit nga zhvillimi i procesit gjyqësor të iniciuar prej denoncuesit me cilësinë e paditësit, me palë të paditur Bashkia Berat, ASHK Berat dhe shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k., me objekt gjyqësor “pushim cenim pronësie dhe kallëzim i një punimi të ri”. Denoncuesi pretendon për gjendje të konfliktit të interesit, të subjektit të rivlerësimit, në këtë çështje pronësore, për shkak se praktika e ASHK-së Berat në adresë të tij është nënshkruar nga vajza e subjektit si titullare e këtij institucioni. Në këtë kontekst, denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga çështja objekt gjykimi. Denoncuesi pretendon për zvarritje të procesit gjyqësor, si dhe për shkelje të etikës nga subjekti duke sqaruar se është refuzuar mbajtja e seancave në audio.

Komisioni administroi⁷⁷ kopje të dosjes gjyqësore.

4.2 Nga aktet rezulton se çështja gjyqësore është regjistruar në datën 23.9.2020 dhe se janë zhvilluar disa seanca, të cilat kanë konkluduar në mospjesëmarrje të palëve dhe, për pasojë, në vijim janë bërë njoftimet përkatëse ndaj tyre, në mungesë të dokumenteve të kërkuara nga gjykata, etj. Vërehet se nga subjekti i rivlerësimit janë kryer veprimet procedurale të caktimit të seancave, por në afate kohore relativisht të gjata. Janë kryer veprimet e tjera procedurale të njoftimit të palëve ndërgjyqëse për të cilat janë administruar fletëthirrjet përkatëse, njoftimi i padisë palëve për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes dhe prapësimet, etj.

4.3 Në një komunikim me *e-mail* datë 15.12.2020, përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar që kjo çështje të trajtohet me përparësi për shkak të shkatërrimit të pronës, ndërsa ka konfirmuar dijeninë e tij se në gjykatë në këtë periudhë trajtoheshin çështje me karakter urgjent për shkak të pandemisë. Në një tjetër seancë, pala e paditur, shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k. ka kërkuar pezullimin pasi kishte hapur një tjetër proces gjyqësor për të cilën ka deklaruar se do të paraqiste dokumentin. Vërehet se seanca (përgatitore) e datës 26.2.2021 dhe ajo e datës 14.4.2021 (seanca përgatitore) është lënë pas një afati një muaj e 15 ditë nga zhvillimi i seancave të mëparshme (për datën 26.2.2021 nga data 28.1.2021 dhe për datën 14.4.2021 nga data 26.2.2021). Në seancën e datës 14.4.2021 gjykata ka revokuar vendimet e mëparshme për legjitimitetin e palës paditëse duke i vlerësuar prokurat e paraqitura nga pala paditëse si nga pikëpamja e përmbajtjes dhe ajo formale në kundërshtim me ligjin. Në këto kushte, gjykata ka vijuar me shtyrjen e seancës përgatitore pas një muaji me qëllim depozitim e prokurave në origjinal, të përkthyer në shqip dhe të notuara. Në këtë seancë nuk rezulton të jetë depozituar ndonjë padi e ngritur nga pala e paditur, shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k., sikurse kjo e fundit ishte shprehur në seancën e kaluar (gjithnjë duke iu referuar përmbajtjes së procesverbalit të seancës përgatitore datë 14.4.2021). Përsëri, rezulton se në datën 14.5.2021, megjithë depozitim e prokurave sipas kërkesës së gjykatës, seanca përgatitore është shtyrë për të shqyrtuar gjykata aktet e paraqitura në seancë, si dhe për shkak të një problemi familjar të gjyqtarit pa u caktuar një datë, por duke u cilësuar në procesverbal se për të do të njoftohen palët me fletëthirrje. Më tej, me vendimin e një tjetër subjekti është vendosur në datë 22.5.2021 përjashtimi i subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i kësaj çështje (në këtë vendimmarrje është trajtuar çështja e konfliktit të interesit e parashtruar me kërkesë të denoncuesit). Gjykata ka vendosur pranimin e saj duke konkluduar në faktin se subjekti nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit por për faktin që ai/subjekti kishte shprehur

⁷⁶Nr. *** prot., datë 20.5.2021.

⁷⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 7.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

qëndrimin e tij për largimin nga gjykimi i kësaj çështje me qëllim distancimin nga njëanshmëria e pretenduar nga denoncuesi.

4.4 Nga verifikimi i kryer në procesverbalet e mbajtura nuk pasqyrohet ndonjë pretendim i denoncuesit lidhur me zhvillimin e seancave me audio.

4.5 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion justifikues, lidhur me pretendimet e denoncuesit, pasi dukej se:(i) procesi ishte zvarritur pa arsye të cilësuar; (ii) nuk ishin kryer veprimet e para procedurale⁷⁸ (pasi në procesverbalin e veprimeve përgatitore datë 28.1.2021, nuk rezulton të jenë konstatuar parregullsi) lidhur me plotësimin e akteve nga pala që vë në lëvizje gjykatën përpara nisjes së procesit të gjykimit, sikurse ka ndodhur me kërkimin e prokurës në versionin origjinal, të notuar sipas ligjit; si dhe (iii) të shpjegojë lidhur me pretendimin e denoncuesit për moszhvillim të seancave me audio; dhe se (iv) në nivelin që ndodhen aktet dhe dosjet objekt gjykimi nuk rezultonte e administruar prokura e përfaqësimit të palës paditëse në versionin e parë dhe më tej ajo origjinale e përkthyer dhe e notruardhe, për këtë konstatim, të depozitonte dokumentin e munguar për të cilin edhe ishin shtyrë seancat përgatitore.

4.6 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar se:(i) është përjashtuar nga gjykimi i kësaj çështjeje me vendim të gjykatës, dhënë nga një tjetër subjekt; (ii) seancat përgatitore janë zhvilluar sipas ligjit procedural civil, Kodi i Procedurës Civile; (iii) nuk rezulton i vërtetë pretendimi i përfaqësuesit të shtetasit K.L, ankuesit R.N, se procesi gjyqësor është zvarritur pa arsye; (iv) seancat përgatitore janë zhvilluar në sallën nr. 5, duke u mbajtur procesverbalet në mënyrë të shkruar (me kompjuter), jo në sistemin audio; (v) të gjitha pretendimet e përfaqësuesit të shtetasit K.L, ankuesi R.N janë sqaruar në mënyrë shteruese nga ILD-ja, e cila në përfundim të verifikimit të ankesës ka vendosur “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga R.N” me vendimin nr.***, datë 22.2.2022. Subjekti ka depozituar vendimin nr. *** prot., datë 22.2.2022, të ILD-së, shoqëruar me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2022.

4.7Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe dokumentacionit të administruar, vëren se ankesa e denoncuesit thuhet të jetë e njëjtë me pretendimet e paraqitura në Komision.Sipas vendimit nr.*** prot., datë 22.2.2022, të ILD-së, është vendosur arkivimi i ankesës për shkak se nga verifikimi i kryer nuk identifikohen veprime të qëllimshme për zvarritje të gjykimit apo shkelje etike dhe, për rrjedhojë, nuk ka fakte të mjaftueshme për të nisur hetimin disiplinor.

Njëkohësisht, vendimi ka trajtuar edhe çështjen e konfliktit të interesit. Vendimi, gjithashtu, ka trajtuar edhe pretendimin e denoncuesit lidhur me moszhvillimin e seancave me audio duke konsideruar zbatimin e nenit 118 të Kodit të Procedurës Penaleku thuhet se në pamundësi procesverbalet mund të mbahen të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Në tërësi, në vendimin e ILD-së duket se janë trajtuar të njëjtat problematika të denoncuar në Komision, si zvarritja në gjykim, moszhvillimi i seancave me audio, por edhe çështja e konfliktit të interesit.

Në të tilla kushte, për sa kohë nga organi kompetent janë trajtuar të njëjtat problematika, Komisioni çmon se mbivendosja e kompetencave tejkalon qëllimin e këtij procesi hetimor dhe, për pasojë, nuk mund të konkludojë për të njëjtat pretendime.

5.Denoncim⁷⁹ i shtetasit R.M (bashkim i dy denoncimeve)

⁷⁸Sikurse e kërkon neni 154 dhe 156 i Kodit të Procedurës Civile.

⁷⁹Nr. *** prot., datë 19.8.2021 dhe nr. *** prot., datë 27.8.2021.

5.1 Denoncuesi ka depozituar dy ankesa me të njëjtin objekt ankimi dhe, ndër të tjera, ankohet se nuk është shpërblyer për tokën e tij që ka pasur në pronësi dhe që ka pranuar ta japë atë në favor të Komunës për varreza të fshatit. Denoncuesi ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor për dy vjet e dy muaj, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit është baxhanak me juristen e Bashkisë, znj. R.LL.

5.2 Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion provues. Ai ka sqaruar se procesi gjyqësor ka përfunduar në datën 29.7.2021.

5.3 Sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 30.7.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, depozituar në Komision nga denoncuesi, rezulton se gjykimi i çështjes ka zgjatur mbi dy vjet (çështja është regjistruar në datën 10.6.2019 dhe ka përfunduar në datën 30.7.2021). Sipas vendimit me nr. ***, datë 14.4.2010, të ish-KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, Aneksi 1, pika 5, germa “e”, afati i gjykimit për çështjet civile të përgjithshme është 6 muaj. Në këtë rast, afati i gjykimit është tejkaluar. Sa i përket pretendimit të denoncuesit se subjekti i rivlerësimit është baxhanak i juristes së Bashkisë, nga verifikimi i mbrojtjes së palëve ndërgjyqëse në vendim rezultoi se përfaqësues i Bashkisë Skrapar është znj. XH.S dhe jo znj. R.LL.

5.4 Për sa më sipër, Komisioni⁸⁰ i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacion mbi arsyet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor, pasi dukej se ishte vepruar në kundërshtim me pikën 5, germën “e” të Aneksit nr.1, të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të ish-KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”.

5.5 Subjekti, ndër të tjera, në parashtrime ka kundërshtuar pretendimet e denoncuesit, se procesi gjyqësor është zvarritur pa arsye nga gjykata. Ai ka shpjeguar se seancat përgatitore dhe seancat gjyqësore janë zhvilluar sipas ligjit procedural civil. Subjekti ka theksuar se janë zhvilluar disa seanca për arsye të njoftimit të ekspertit vlerësues, për përsëritje njoftimi, për dhënie kohe ekspertit për të kryer aktekspertimin, për dhënie kohe palëve për njohje me aktekspertimin për njoftim të ekspertit kontabël, për shkak të pezullimit të punës për arsye të pandemisë, paaftësi të përkohshme të tij në punë, për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve efektivë në atë gjykatë, pavarësisht strukturës për 10 gjyqtarë, pra për shkak edhe të ngarkesës së punës, etj. Në lidhje me statusin, subjekti ka konfirmuar se çështja vijon të jetë për gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë mbi bazë ankimi, pasi është vendosur rrëzimi i padisë prej tij në shkallë të parë. Subjekti ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 30.7.2021, shkresën ku konfirmohet përcjellja e dosjes gjyqësore në Gjykatën e Apelit Vlorë, procesverbalet e seancave gjyqësore, të dhëna mbi ngarkesën e subjektit në punë, raporte të paaftësisë së përkohshme, etj.

5.6 Në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të administruar, përfshirë edhe procesverbalet e seancave të zhvilluara ku janë qartësuar edhe arsyet e shtyrjeve, duket se çështja ka qenë komplekse dhe se zvarritja ka ardhur për arsye të shpjeguara dhe objektive që lidhen ngushtësisht me zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor duke ushtruar secila palë të drejtën dhe detyrimin përkatës. Në të tilla kushte nuk diktohen problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

6. Denoncim⁸¹ i shtetasit D.I (bashkim i dy denoncimeve)

6.1 Denoncuesi denoncon në ankimin e tij vendimmarrjen e pushimit, të marrë nga subjekti i rivlerësimit, për çështje me objekt gjykimi marrëdhënie punësimi. Ai parashtron se ka kërkuar përjashtimin e subjektit nga gjykimi i çështjes, pasi ka pasur konflikt me të duke qenë se është treguar i njëanshëm. Ankohet gjithashtu se nuk është njoftuar për datën që do të

⁸⁰Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

⁸¹Nr. *** prot., datë 18.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 9.5.2019.

merrej vendimi, pretendon se ka dorëzuar raport mjekësor dhe se subjekti është i korruptuar, duke pretenduar se ka dhënë një shumë të caktuar e cila nuk i është kthyer.

Komisioni administroi⁸² kopje të dosjes gjyqësore (që i përket vendimit nr. ***, datë 25.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat).

6.2 Nga aktet e administruara rezultoi se çështja me palë paditëse/denoncuesin, të paditur/shërbimin privat të sigurisë fizike “****” sh.p.k. dhe filialin e këtij shërbimi me objekt/detyrimin për ta dëmshpërblyer me një vit pagë mujore për mosrespektim të afateve të njoftimit, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, etj. është regjistruar në gjykatë në datën 15.1.2019 dhe ka përfunduar në datën 25.3.2019, pra brenda një afati të arsyeshëm.

6.3 Denoncuesi ankohet se nuk është njoftuar për seancën e datës 25.3.2019, ndërsa sipas procesverbalit datë 20.3.2019⁸³ rezulton se është njoftuar nëpërmjet ftuesit gjyqësor në numrin e telefonit të vënë në dispozicion prej tij.

6.4 Denoncuesi pretendon se ka dorëzuar raport mjekësor, ndërsa në dosje është administruar një rekomandim mjeku⁸⁴ i datës 25.3.2019.

6.5 Në procesverbalin e seancës përgatitore datë 12.2.2019 është pasqyruar prezenca e palëve, është pasqyruar fakti që nuk është pranuar kërkesa e paditësit për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i kësaj çështjeje.

6.6 Nga paditësi në këtë procesverbal është deklaruar fakti se nuk ka pasur kontratë pune. Pala e paditur e ka mohuar një fakt të tillë, duke sqaruar se ka pasur kontratë në periudhë prove dhe deklaroi se e ka dorëzuar atë.

6.7 Në procesverbalin e seancës së datës 18.3.2019, seancë kjo e caktuar për t’u paraqitur diskutimet përfundimtare të palëve, pasqyrohet mosprezenca e palës paditëse për shkak të rekomandimit të mjekut dhe në këto kushte seanca është shtyrë në datën 25.3.2019.

6.8 Në procesverbalin e seancës së datës 25.3.2019 është pasqyruar mosprezenca e palës paditëse, është vijuar me kërkimet përfundimtare të palës së paditur dhe është vendosur rrëzimi i padisë me vendimin nr. ***, datë 25.3.2019. Ndaj këtij vendimi rezultoi se denoncuesi në datën 18.4.2019 ka ushtruar ankim.

6.9 Sa i përket pretendimit të denoncuesit për veprime korruptive të subjektit të rivlerësimit, duket se pretendimi ka mbetur në nivel deklarativ. Nga vendimet gjyqësore të rrëzimit të dy kërkesave për përjashtim gjyqtari, pretendimi i denoncuesit ka pasur si referencë mendimin e tij se përgjithësisht vendimet e subjektit dhënë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Skrapar kanë qenë të njëanshme, ndërsa për të provuar këtë pretendim nuk ka depozituar ndonjë provë.

6.10 Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me shqyrtimin e çështjes dhe ndjekjen e procedurës ligjore, por i kërkoi subjektit të qartësojë statusin aktual të çështjes, pas ushtrimit të së drejtës ankimore nga pala paditëse, si dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës. Po ashtu, Komisioni vërejti se në gjendjen që ndodheshin aktet në dosje, nuk ishte administruar kontrata e punësimit, e lidhur mes paditësit dhe palës së paditur dhe për këtë i kërkoi subjektit të depozitonte këtë akt.

6.11 Subjekti, lidhur me statusin aktual të çështjes, ka qartësuar se ajo është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 26.4.2022, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 25.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat”. Gjithashtu, ka kundërshtuar pretendimet e denoncuesit duke theksuar se janë të pabazuara në ligj dhe në

⁸²Shkresë nr. *** prot., datë 17.6.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁸³Renditur në dosje në f.*** dhe f.*** formulari i të dhënave të kontaktit.

⁸⁴Renditur në f.*** në dosje.

prova. Subjekti ka qartësuar se ky denoncues ka paraqitur në të njëjtën gjykatë edhe padi të tjera për të njëjtin fakt juridik, të cilat sipas tij janë haptazi abuzive. Gjithashtu, ka qartësuar se vendimi i dhënë prej tij është sipas ligjit dhe provave, duke theksuar se denoncuesi shpif dhe hedh baltë mbi figurën e tij. Subjekti ka depozituar dokumentacion mbi shpjegimet e dhëna, si dhe kontratën individuale të punës, objekt i gjykimit të marrëdhënieve të punësimit, datë 12.4.2018, të shoqërisë së shërbimit privat të sigurisë fizike “****”, lidhur me shtetasin I.

6.12 Komisioni në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të depozituar konstaton se çështja objekt i këtij hetimi administrativ nuk identifikon shkelje të natyrës procedurale të kryera nga subjekti dhe njëkohësisht vëren se ligjshmëria e vendimmarrjes së subjektit është vlerësuar nga gjykatat e shkallëve më të larta. Në të tilla kushte nuk konstatohen problematika të cilat ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

7.Denoncim⁸⁵ i shtetasit B.T (bashkim i dy denoncimeve)

7.1 Denoncuesi, së bashku me bashkëshorten e tij, ankohen për vendim të padrejtë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin njëkohësisht deklarojnë se kanë ushtruar edhe të drejtën ankimore. Sipas parashtrimeve në denoncim ata janë dënuar me gjobë për veprën penale “dëmtime të kryera me dashje”, ndaj shtetasit T.P. Për këtë çështje, denoncuesit ankohen se janë dënuar me pa të drejtë, se në dëm të tyre janë sajuar situata. Në tërësi, ata kërkojnë të zbardhet situata e krijuar. Denoncuesit kanë depozituar vendimet gjyqësore⁸⁶, si dhe ankimin e organit të akuzës kundër vendimit nr.***, datë 28.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

7.2 Nga aktet e administruara vërehet se mes denoncuesve dhe shtetasit T.P ka pasur një konflikt të hapur për një vjedhje në bashkëpunim (për një procedim të regjistruar në vitin 2018) të shkaktuar nga vëllai i shtetasit P, çështje kjo e hetuar dhe e përfunduar nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 28.12.2020, me të cilin shtetasit M.P dhe H.P janë dënuar përkatësisht me 9 muaj dhe 6 muaj burgim, duke u pezulluar ekzekutimi i vendimit dhe vendosur vënia e të dënuarve në periudhë prove. Ky vendim rezulton i ankimuar nga organi i akuzës, pasi ky i fundit nuk ka qenë dakord me aplikimin e nenit 59 në vendimmarrje/me pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal. Më tej, rezulton se situata ka agravuar dhe kanë vijuar konfliktet me vëllain e shtetasit M.P, shtetasin T.P, pas së cilës kanë rrjedhur edhe çështjet gjyqësore (kërkesat penale sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale) të cituara në vijim. Denoncuesit kanë depozituar krahas vendimit gjyqësor të dhënë nga subjekti i rivlerësimit nr.***, datë 25.10.2021 edhe vendimin nr.***, datë 6.12.2019, të dhënë nga një tjetër subjekt rivlerësimi.

7.3 Në analizë të dy vendimeve gjyqësore rezulton se në vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit që është i mëvonshëm, viktimë akuzuese është shtetasi T.P dhe të akuzuar janë shtetasit B.T dhe bashkëshortja e tij N.T, akuzuar për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, sipas nenit 90/2 të Kodit Penal, për të cilën janë dënuar përkatësisht me gjobë në vlerat 60.000 lekë dhe 50.000 lekë. Ndërsa në vendimin e dhënë më parë nga një tjetër subjekt rivlerësimi viktimë akuzuese janë anasjelltas, bashkëshortët T, i akuzuar është shtetasi P, akuzuar për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, sipas nenit 90/2 të Kodit Penal, për të cilin ky i fundit është deklaruar fajtor dhe është dënuar me vendim të formës së prerë (nr. ***, datë 25.6.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë) me një muaj burgim. Në arsyetim të të dy vendimeve duket se trajtohen të njëjtat rrethana dhe shkaqe për një konflikt të ndodhur mes palëve në datën 8.5.2019.

⁸⁵Nr. *** prot., datë 12.11.2021 dhe nr.*** prot., datë 27.9.2022.

⁸⁶Nr.*** prot., datë 28.12.2020; nr. *** prot., datë 6.12.2019; nr. *** prot., datë 7.10.2020 dhe nr. *** prot., datë 25.10.2021.

7.4 Nga verifikimi i vendimit të parë datë 6.12.2019 (dhënë nga një subjekt tjetër) rezulton se për të tre shtetasit cilësohen dhe arsyetohet mbi secilin raport mjekësor të tyre dhe, po ashtu, edhe në vendimin e subjektit të rivlerësimit duket se sërish gjykohet po për të njëjtën çështje dhe po mbi të njëjtat prova, më konkretisht, arsyetohet dhe konkludohet duke u bazuar sërish në të njëjtin raport mjekësor dhënë shtetasit T.P, provë kjo që duket se është vlerësuar një herë që në gjykimin e parë, nga ku edhe gjykata ka konkluduar në fajësinë e këtij shtetasi dhe dënimin e tij me një muaj burgim, ndërsa në rastin e gjykuar nga subjekti dënohen shtetasit T. Për gjykimin e parë çështja gjyqësore është regjistruar në datën 17.5.2019 – për ngjarjen e ndodhur në datën 8.5.2019, ndërsa për gjykimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit, çështja gjyqësore është regjistruar⁸⁷ në datën 12.5.2021 – gjithashtu po për ngjarjen e ndodhur në datën 8.5.2019 (rreth dy vjet pasi ka ndodhur ngjarja).

7.5 Duket se në vendimin e subjektit të rivlerësimit nuk identifikohet asnjë e dhënë në lidhje me dënimin e shtetasit T.P, me 1 muaj burgim, dy vjet më parë për të njëjtën çështje. Në këtë vendim organi i akuzës ka kërkuar deklarimin e pafajshëm të shtetasve T.

7.6 Për sa më sipër, Komisioni⁸⁸ i kërkoj subjektit të rivlerësimit:(i) të japë shpjegime lidhur me pretendimet e denoncuesve për ngjarjen e ndodhur në maj të vitit 2019 për të cilën janë dënuar respektivisht; në vitin 2019 shtetasi T.P dhe në vitin 2021 shtetasit T dhe ku si provë në të dyja rastet është administruar akti mjeko-ligjor nr. ***, datë 13.5.2019, duke u konsideruar shpjegimet e dhëna edhe në raport me kërkimin e organit të akuzës për të deklaruar të pafajshëm të akuzuarit; (ii) të qartësojë dhe depozitojë dokumentacion, mbi situatën e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë për dënimin e shtetasit T.P me 1 muaj burgim, si dhe (iii) të depozitojë diskutimin përfundimtar të përfaqësuesit të organit të akuzës në këtë çështje të gjykuar prej tij, çështje e vënë në lëvizje nga kërkesa penale e shtetasit T.P.

7.7 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka sqaruar se vepra penale dëmtime të tjera me dashje konsiderohet kundërvajtje penale. Ai ka referuar legjislacionin penal (nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale) të aplikueshëm në këto raste gjykimi. Gjithashtu ka qartësuar se të dyja kërkesat në mënyrë të veçantë janë gjykuar nga trupa gjykues të ndryshëm dhe në periudha të ndryshme. Subjekti ka shpjeguar se të akuzuarit nuk paraqitën asnjë provë në gjykatë për të provuar të kundërtën, pra se ata nuk e kishin dëmtuar ankuesin. Subjekti ka konfirmuar se vendimi i tij është lënë në fuqi nga një gjykatë më e lartë. Subjekti ka depozituar vendimet gjyqësore, procesverbalet e seancave, si dhe dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e subjektit nr.***, datë 25.10.2021.

7.8 Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna, legjislacionit të aplikueshëm, i cili në këto raste i jep të drejtë se cilës palë të dëmtuar në mënyrë të veçantë të ushtrijë ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë, si dhe faktit që vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit është ligjëruar nga gjykata më e lartë, nuk konstaton problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit.

8.Denoncim⁸⁹ i shtetas M.B

8.1 Denoncuesja ankohet ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, ku ndër to identifikon edhe subjektin, objekt i këtij hetimi administrativ. Denoncimi referon kryesisht një çështje civile pronësore në dukje me shumë konflikte dhe komplekse për t'u zgjidhur. Për çështjen⁹⁰ duket

⁸⁷Mbi kërkesën e palës sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale.

⁸⁸Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

⁸⁹Dërguar me e-mail datë 3.12.2021 dhe nr.*** prot., datë 3.7.2018.

⁹⁰Për të cilën janë administruar dosjet gjyqësore me shkresën nr.*** prot., datë 13.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

se janë marrë disa vendime gjyqësore nga shkallë të ndryshme të gjyqësorit dhe që për pasojë denoncuesja ankohet thujse ndaj të gjithë vendimeve dhe, po ashtu, edhe ndaj shumë gjyqtarëve. Ndër të tjera konstatohet se nga denoncuesja dhe trashëgimtarë të tjerë të të ndjerit gjyshit të tyre T.J është kërkuar sigurim padie për një pronë të pretenduar dhe kërkuar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave për t'u kthyer, tek e cila, sipas saj, shoqëria “****” sh.p.k. ka marrë leje minerare për kërkim-zbulim guri gëlqeror, është bërë kallëzim ndaj kësaj shoqërie, administratorit të saj, nën pretendimin se ka tejkaluar lejen e marrë, e shfrytëzon pronën në mënyrë të paligjshme, etj. Për këtë çështje thuhet se është vënë në lëvizje gjykata edhe me padi për cenim pronësie, janë bërë bashkime çështjesh edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë sapo është rënë në dijeni të faktit të disa proceseve gjyqësore në gjykim, të nisura nga të njëjtat palë me të njëjtin objekt kërkimi, etj.

8.2 Në aktet e administruara në adresë të subjektit identifikohet vetëm një vendimmarrje e datës 28.2.2018, me objekt pezullimin e gjykimit të çështjes civile kërkuar pikërisht nga znj. M.B dhe të tjerë persona me cilësinë e paditësve, me palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k. Në këtë rast subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës. Edhe nga dëgjesa e CD-ve përkatëse⁹¹ nuk identifikohet subjekti i rivlerësimit.

8.3 Komisioni, nga verifikimi i akteve të administruara, nuk identifikoi fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

9.Denoncim⁹² i shtetasit A.J (bashkim i katër denoncimeve)

9.1 Denoncuesi J është në lidhje fisnore me shtetasen M.B (J) dhe njëkohësisht ankohet ndaj disa gjyqtarëve po për të njëjtën çështje pronësie, sikurse shtetasja B dhe trashëgimtarët e tjerë, të cilët trashëgojnë nga i ndjeri gjyshi i tyre T.J. Por në këtë rast, denoncimi i tij trajton konfliktin e ndërsjellë që ka me znj. M.B, krahas problemeve thelbësore të çështjes së pasurisë. Denoncuesi nuk identifikon shkelje ndaj subjektit të rivlerësimit, por kryesisht ka parashtruar përplasjen e interesave që ka me bashkëpronarët për shkak se janë të shumtë në numër dhe kërkesat e ndryshme drejtuar gjykatës, kryesisht për përjashtimin e gjyqtarëve, sipas tij kanë ndikuar negativisht në gjykimin e çështjes së themelit, përfitimit dhe gëzimit të pronës.

9.2 Komisioni, pasi u njoh dhe trajtoi denoncimin, nuk konstatoi fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit.

10.Denoncim⁹³ i shtetasit A.S (bashkim i dy denoncimeve)

10.1 Denoncuesi (babai i njërit prej personave në hetim, I.M) ankohet ndaj qëndrimit të subjektit të rivlerësimit në gjykimin e çështjes penale ndaj shtetasve D.E, I.M, etj., akuzuar për veprat penale “vrasje”e kryer në bashkëpunim, si dhe “armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 79/dh, 22, 25 dhe 278/1 të Kodit Penal.

10.2 Denoncuesi ankohet për njëanshmëri të trupit gjykues në veprimet procedurale të ndjekura përgjatë shqyrtimit të çështjes. Ai pretendon se është kërkuar përjashtimi, por kërkesa nuk është pranuar.

10.3 Nga denoncuesi pretendohet se të pandehurit qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në burg, ndërsa avokatët e tyre kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur shuarje të masës së sigurisë dhe se kërkesat e tyre gjithashtu janë rrëzuar. Gjithashtu, denoncuesi sqaron se edhe organi i akuzës ka kërkuar shuarjen e masës së sigurisë, por ajo nuk është pranuar nga gjykata.

⁹¹Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 5.8.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

⁹²Nr. *** prot., datë 1.11.2019; nr. *** prot., datë 29.7.2019; nr. *** prot., datë 30.12.2019; dhe nr. *** prot., datë 25.9.2019.

⁹³Nr. *** prot., datë 12.7.2022 dhe nr. ***prot., datë 26.9.2022.

10.4 Denoncuesi pretendon se nga trupi gjykues është shkelur neni 263/2 i Kodit të Procedurës Penale.

10.5 Denoncuesi pretendon për shkelje të nenit 350/3 të Kodit të Procedurës Penale nga trupi gjykues në adresë të përfaqësuesve ligjorë të të pandehurve, duke sqaruar se megjithë prokurat e dhëna avokatëve për të përfaqësuar së bashku apo veç e veç (pasi janë autorizuar dy avokatë) të pandehurit, njëri prej tyre i munguar në një seancë (në datën 16.5.2022) është ndëshkuar me pa të drejtë me gjobë.

10.6 Denoncuesi pretendon se në seancën e datës 26.5.2022 mbrojtjes nuk i është dhënë e drejta e fjalës, duke u cenuar kështu parimi akuzator i gjykimit.

10.7 Komisioni i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat kopje të dosjes penale që i përket shqyrtimit të masës së sigurimit personal, si dhe kërkesës lidhur me shuarjen e masës së sigurisë, ashtu sikurse është parashtruar në denoncimin përkatës. Gjykata⁹⁴ ka informuar se nga kërkimet e bëra në sistemin e saj të regjistrimit dhe menaxhimit të çështjeve nuk rezulton të jenë shqyrtuar kërkesa të tilla, që i përkasin shtetasve të përmendur në denoncim.

10.8 Në denoncimin e radhës denoncuesi ka depozituar vendimet gjyqësore për kërkimin e shuarjes së masës së sigurimit ndaj të pandehurve, kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kallëzimin penal datë 12.3.2022 ndaj trupit gjykues, ku bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit. Nga dokumentacioni i administruar u vërejt se subjekti i rivlerësimit dhe anëtarët e tjerë kanë gjykuar të deleguar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

10.9 Ankuesi pretendon se është shkelur afati 12-mujor i qëndrimit të të pandehurve në paraburgim dhe, për pasojë, është shkelur neni 263/2 i Kodit të Procedurës Penale, pasi sipas tyre praktika njehsuese e Kolegjit të Gjykatës së Lartë (vendimi nr. ***, datë 1.11.2021), afatin 12-mujor e parashikon të nisur prej momentit të dorëzimit të akteve për gjykim, në gjykatë, nga organi i akuzës (që sipas tyre është data 5.11.2020), për rastet kur nga gjyqtari paraprak është vendosur kalimi i çështjes për gjykim. Në vendimin e praktikës njehsuese citohet pika 42/2: *“Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjykimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq;...”*.

10.10 Ankuesit pretendojnë se deri aktualisht janë mbushur 22 muaj që të pandehurit qëndrojnë në burg dhe se për ta ende nuk është dhënë vendimi në shkallë të parë.

10.11 Në vijim pretendojnë për të njëjtën shkelje procedurale po lidhur me shuarjen e masës së sigurimit, për shkak se edhe në rekursin e depozituar prej tyre, pas të cilit me vendimin nr. ***, datë 23.6.2022, ku është vendosur mospranimi⁹⁵ ndaj vendimit nr. ***, datë 17.12.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë⁹⁶, në pjesën arsyetuese, ndër të tjera, thuhet⁹⁷: *“Afati 12-mujor referuar veprave penale për të cilat po gjykohen të pandehurit/kërkuesit, i parashikuar nga shkronja ‘c’, e pikës 2, të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale do të fillojë nga momenti i dorëzimit të akteve pranë gjyqtarit të seancës paraprake. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se gjykata e faktit ka interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural penal...”*.

⁹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 5.8.2022.

⁹⁵Kjo vendimmarrje ka ardhur si rezultat i moskontestimit nga ankuesit të një pjese arsyetuese të vendimit të apelit lidhur me përlllogaritjet e kryera nga kjo gjykatë për shkak se përgjatë fazës së seancës paraprake ishte vendosur pezullimi i afateve të paraburgimit për katër ditë dhe në këto kushte ka konkluduar se kjo ka qenë një arsye më shumë që nuk ishin përmbyllur afatet e duhura për shuarje të masës së sigurimit.

⁹⁶Ky i fundit ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 18.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (i paadministruar në provat e denoncuesit).

⁹⁷Shihni arsyetimin e bërë në pikat 28 dhe 29 të vendimit.

10.12 Ndërkohë, ankuesit kanë depozituar pesë vendime me të njëjtin trup gjykues, ku pjesë përbërëse është edhe subjekti i rivlerësimit, me objekt kërkesë “shuarje e masës së sigurimit”, për shkak të kalimit të afatit të paraburgimit, përkatësisht për dosjen me nr. akti ***, katër vendime në datat 11.2.2022, 11.3.2022, 11.4.2022 dhe 26.5.2022, si dhe vendimin nr. ***, datë 24.2.2022, që në tërësi duket se janë dhënë pas praktikës njehsuese të Gjykatës së Lartë.

10.13 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se dukej se: (i) vendimmarrjet e dhëna nga trupi gjykues (ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit) pas praktikës njehsuese të Kolegjit të Gjykatës së Lartë⁹⁸ nuk janë vlerësuar në raport me këtë të fundit dhe parashikimin ligjor të figurës dhe rolit të gjyqtarit të seancës paraprake; (ii) në vendimin nr. ***, datë 18.11.2021 është interpretuar gabim ligji procedural penal, sikurse është shprehur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në arsyetimin e bërë në vendimin nr. ***, datë 23.6.2022, pikat 28 dhe 29. Në këto kushte, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime dhe të depozitojë çdo dokumentacion mbështetës.

10.14 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtrime ka shpjeguar se: (i) në këtë gjykim nuk ka pasur asnjëherë rolin e gjyqtarit të seancës paraprake, por ka qenë anëtar i trupit gjykues që po shqyrton themelin e çështjes; (ii) në asnjë vendimmarrje të marrë nga trupi gjykues ku bën pjesë, nuk është diskutuar roli i gjyqtarit të seancës paraprake dhe as llogaritja e afateve të paraburgimit, që ecin gjatë fazës së seancës paraprake, por është zbatuar afati tërësor i paraburgimit sipas nenit 263, pika 6 e Kodit të Procedurës Penale; (iii) trupi gjykues ku bën pjesë ka rrëzuar kërkesat e të pandehurve me objekt shuarjen e masave të sigurimit “arresti në burg” të caktuara ndaj tyre me vendimet e datave 11.2.2022, 11.3.2022, 11.4.2022 dhe 26.5.2022 dhe në këtë kohë vendimi njehsues nuk ishte zbardhur dhe nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare; (iv) dy nga vendimet e dhëna nga ky trup gjykues, konkretisht, vendimet e datave 11.2.2022 dhe 11.3.2022 kanë qenë objekt ankimi dhe janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila me vendimet nr. ***, datë 27.4.2022 dhe ***, datë 27.4.2022 ka vendosur lënien e tyre në fuqi dhe se këto dy vendime nuk janë ankimuar; (v) të gjitha vendimmarrjet e trupit gjykues ku ka qenë pjesë, bazohen në afatin tërësor të paraburgimit dhe dy prej tyre janë lënë në fuqi, ndërsa të tjerat, duke filluar nga ajo e datës 11.4.2022 janë ankimuar dhe ende nuk është marrë ndonjë vendim nga Gjykata e Apelit Vlorë; (vi) edhe pse është marrë vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka shqyrtuar një vendim që nuk ishte dhënë prej tij, sërish Gjykata e Lartë nuk rezulton të ketë urdhëruar lirimimin e të pandehurve për shkak të kalimit të afatit dhe as nuk është shprehur në ndonjë pikë të arsyetimit se nuk duhet të zbatohen afatet tërësore të paraburgimit; (vii) në rastin konkret, ankesat/kallëzimet janë tentuar të përdoren si formë intimidimi ndaj trupit gjykues. Subjekti ka depozituar të gjitha vendimet gjyqësore të gjykatave, procesverbale të seancave gjyqësore, vendimin e mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe vendimin e lënies në fuqi të vendimit të mosfillimit, etj.

10.15 Komisioni, në analizë të dokumentacionit të depozituar, i cili hedh dritë të plotë mbi ecurinë e këtij procesi gjyqësor, vëren se vendimi (nr. ***) për rrëzimin e kërkesës “shuarje masë sigurimi” për të cilën shprehet Gjykata e Lartë është dhënë në datën 18.11.2021 nga një tjetër trup gjykues. Gjykata e Lartë, me vendimin dhënë në datën 23.6.2022, e quan në shkelje procedurale vendimmarrjen e shkallës së parë dhe apelit që kishte lënë në fuqi vendimin nr. ***, pavarësisht mospranimit të rekursit. Në këtë rast, trup gjykues i shkallës së parë ka vendosur “rrëzimin e kërkesës për shuarje të masës së sigurimit”, duke interpretuar nenin 263 të Kodit të Procedurës Penale se afati fillon nga momenti i dorëzimit të akteve

⁹⁸Shihni vendimin nr. ***, datë 1.11.2021 ku, ndër të tjera, thuhet pika 42/2: “Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjykimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për: a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq; ...”.

gjyqtarit të themelit⁹⁹. Trupi gjykues ku bën pjesë subjekti ka dhënë përpara shpalljes së vendimit të Gjykatës së Lartë po për këtë objekt kërkimi, vendime rrëzimi përkatësisht në datat 11.2.2022, 11.3.2022, 11.4.2022, 26.5.2022, 26.7.2022 dhe 19.9.2022. Rezultojnë se vendimet e dhëna nga trup gjykues ku bën pjesë subjekti i rivlerësimit, përkatësisht datat 11.2.2022 dhe 11.3.2022, janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe në të dyja rastet është vendosur lënia e tyre në fuqi. Po ashtu, vërehet se në vendimet e datave 11.3.2022 dhe 11.4.2022 trupi gjykues është shprehur lidhur me mosmarrjen në konsideratë të vendimit njehsues të Gjykatës së Lartë, sipas pretendimit të kërkuesve për shkak se nuk rezultonte ende i botuar në fletore zyrtare, ndërsa është shprehur edhe pas publikimit të tij në vendimet e radhës, konkretisht, dhënë në datat 26.7.2022 dhe 19.9.2022, duke arsyetuar se vendimi njehsues i Gjykatës së Lartë nuk është shprehur në lidhje me zbatimin e afatit tërësor të paraburgimit, por ka njehsuar praktikën lidhur me përlogaritjet e periudhës së paraburgimit të vuajtur në fazën e hetimit paraprak apo në fazën e gjykimit. Pra, në tërësi duket se në vendimmarrjet e dhëna nuk është anashkaluar ky pretendim i palëve në kërkim.

Gjithashtu, nga analizimi i vendimeve të dhëna pas praktikës njehsuese të Gjykatës së Lartë, përkatësisht në datat 26.7.2022 dhe 19.9.2022, vërehet se në arsyetimin e tyre është referuar dhe pasqyruar edhe vendimi nr. ***, datë 23.6.2022, i Gjykatës së Lartë, me të cilin ishte vendosur mospranimi i rekursit.

Trupi gjykues, duke konsideruar edhe shpjegimet e detajuara të subjektit të rivlerësimit, përgjithësisht nuk vëren problematika thelbësore të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se në leximin literar që i bëhet nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale¹⁰⁰, duket se për të vlerësuar dhe gjykuar bazuar në nenin 263/6 të këtij Kodi, duhen ezauruar pikat 3, 4 dhe 5 të kësaj dispozite, pra afatet tërësore duket se përfshijnë rastet kur të pandehurit janë dënuar sikurse thuhet në pikën 3 të nenit 263 të këtij Kodi dhe për ta ende nuk është shqyrtuar çështja në apel apo kur çështja priset nga Gjykata e Lartë dhe dërgohet për rigjykim në njërin nga gjykatat më të ulëta. Për rrjedhojë, duket se në këtë rast arsyetimi i vendimit nuk është i qartë në drejtim të interpretimit, se kujt faze procedurale i përkasin afatet e paraburgimit, nisur kjo edhe nga kërkimi i palëve.

Në konkluzion, trupi gjykues konstaton se: (i) përsa kohë çështja duket të jetë komplekse, (ii) po ashtu përsa rezultoi se për kërkesat e shuarjes së masës së sigurimit janë ndërmarrë një sërë veprimesh apo edhe vendimmarrje, (iii) në një kohë që Gjykata e Lartë në vendimmarrjen e saj nuk është shprehur lidhur me afatin tërësor të paraburgimit, (iv) pa zëvendësuar logjikën e arsyetimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk mund të konkludojë në problematika ndaj subjektit të rivlerësimit.

11.Denoncim¹⁰¹ i shtetasit A.F

11.1 Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit dhe e akuzon atë si të korruptuar me palën kundërshtare.

11.2 Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pyetur të gjithë dëshmitarët okularë të ngjarjes. Ankohet se nuk konsideron kërkesën e tij për ekspertim tjetër dhe riekspertim nga ekspertë të Drejtorisë së Policisë Rrugore. Denoncuesi ankohet se subjekti i rivlerësimit jep vendime të njëanshme dhe të paligjshme. Denoncuesi nuk ka depozituar ndonjë provë.

⁹⁹“Afati 12-mujor referuar veprave penale për të cilat po gjykohen të pandehurit/kërkuesit, i parashikuar nga shkronja ‘c’, e pikës 2, të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, do të fillojë nga momenti i dorëzimit të akteve pranë gjyqtarit të seancës paraprake. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se gjykata e faktit kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin procedural penal ...”

¹⁰⁰Referuar më gjerësisht edhe vendimit nr.6, datë 11.11.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁰¹Nr.*** prot., datë 20.6.2019.

11.3 Komisioni administroi¹⁰² kopje të dosjes gjyqësore (që i përket vendimit nr. ***, datë 2.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat).

11.4 Nga aktet e administruara konstatohet se denoncuesi është deklaruar fajtor me vendimin e lartpërmendur dhe është dënuar me tre vjet burgim për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Edhe organi i akuzës ka kërkuar¹⁰³ deklarimin fajtor të shtetasit V dhe dënimin e tij me katër vjet burgim. Sipas aktekspertimit auto-teknik (thuhet në diskutimin përfundimtar të organit të akuzës) shkakun determinant është shkelja e rregullave të qarkullimit nga ana e drejtuesit të mjetit (shtetasit V). Ngjarja i referohet një aksidenti të ndodhur mes dy automjeteve, konkretisht, automjetit tip “Chevrolet” të policisë drejtuar nga shtetasi V, punonjës policie i cili udhëtonte së bashku me një tjetër punonjës policie (që ka gjetur vdekjen pas aksidentit) dhe një automjeti tjetër tip “Golf” me të cilin udhëtonte shtetasi E.SH dhe prindërit e tij.

11.5 Lidhur me pretendimet e denoncuesit për shkelje të kryera nga subjekti për shkak të disa kërkesave të bëra prej tij¹⁰⁴, më konkretisht, për kryerjen e një ekspertimi të ri auto-teknik, pyetjen e disa dëshmitarëve, si dhe pyetjen e të pandehurit, rezulton se subjekti është shprehur me vendim të ndërmjetëm në procesverbalin e datës 2.5.2019¹⁰⁵. Gjithashtu, lidhur me kërkimin e denoncuesit për përjashtimin e subjektit nga gjykimi i çështjes për shkak të mosmarrjes në konsideratë plotësisht të kërkesave të denoncuesit, subjekti ka shprehur mendimin e tij¹⁰⁶ megjithë argumentet e dhëna për t’u pranuar kërkesa. Rezulton se kjo kërkesë është rrëzuar me vendimin nr. ***, datë 30.5.2019, të një tjetër subjekti rivlerësimi.

11.6 Vërehet se çështja aktualisht është në gjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë mbi ankimin e denoncuesit. Në kushte të tilla, Komisioni nuk ka tagrin të konkludojë lidhur me këtë çështje.

12. Denoncim¹⁰⁷ i shtetasit V.S (bashkim i dy denoncimeve)

12.1 Denoncuesi në ankimin e tij ankohet ndaj vendimit datë 7.12.2011 të subjektit të rivlerësimit, dhënë ndaj vendimit datë 20.5.2011, të prokurorit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat për mosfillimin e procedimit penal për materialin referues nr.***, duke dëmtuar interesat e tij si kallëzues ndaj shtetasit A.V, për veprën penale “shkatërrim të pronës”.

12.2 Nga përmbajtja e denoncimit vërehet se çështja i referohet një konflikti pronësor mbi disa parcela të blera nga denoncuesi dhe të pretenduara si të cenuara nga shtetasi V, për të cilin denoncuesi ka paraqitur edhe kallëzim ndaj tij. Nga aktet e depozituara nga denoncuesi vërehet se çështja penale ka ndjekur shkallët e gjyqësorit bazuar në ankimin e herëpashershëm të denoncuesit, pikërisht, ndaj vendimit të mosfillimit të organit të prokurorisë.

12.3 Duket se denoncuesi kërkon të shqyrtohet themeli i çështjes, i cili ka lidhje me vendimmarrjen e subjektit dhe nuk paraqet ndonjë problematikë lidhur me shkelje të karakterit procedural. Komisioni nuk ka tagrin të zëvendësojë apo interpretojë logjikën e arsytimit të bërë në vendimmarrje nga subjekti i rivlerësimit.

12.4 Në të tilla kushte duket se nuk vërehen problematika të cilat mund të ndikojnë në rivlerësimin e kriterit profesional të subjektit.

¹⁰²Me shkresën nr. *** prot., datë 17.6.2022, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹⁰³Në diskutimin përfundimtar datë 25.7.2019, renditur në f. *** në dosje.

¹⁰⁴Në parashtrimin e avokatit, datë 20.3.2019, renditur në f. *** në dosjen gjyqësore.

¹⁰⁵Renditur në f. *** në dosjen gjyqësore.

¹⁰⁶Mbi kërkesën për përjashtim, renditur në f. *** të dosjes.

¹⁰⁷Nr. *** prot., datë 21.7.2021, ardhur nga IKP-ja me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2021 dhe nr. *** prot., datë 21.7.2021, drejtuar IKP-së.

13.Denoncim¹⁰⁸ i shtetasit M.K

Denoncuesi në denoncim ka përmendur një numër të konsiderueshëm subjekte rivlerësimi, ndër to edhe subjektin, objekt i këtij hetimi administrativ, pa pasqyruar ndonjë shkelje konkrete të kryer prej tij. Parashtrimet në denoncim duket se janë paraqitur në formë të pështjelluar dhe nuk identifikohet objekti konkret i ankimit. Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion provues, përveçse një raport mjekësor në emër të tij për paaftësi të përkohshme në punë.

Komisioni vëren se denoncimi nuk paraqet fakte dhe rrethana, të cilat kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit.

14.Denoncim¹⁰⁹ i përcjellë nga Komisioneri Publik, i shtetas M.B

14.1 Komisioni administroi¹¹⁰ dokumentacionin e përcjellë nga Komisioneri Publik lidhur me këtë denoncim, së bashku me CD-në përkatëse.

14.2 Nga aktet e administruara rezulton se znj. M.B (sikurse është trajtuar edhe më sipër në këtë rubrikë) ka adresuar edhe në këtë rast denoncimin e saj të përsëritur të depozituar edhe në Komision. Denoncuesja ankohet ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, ndër to edhe për subjektin e rivlerësimit. Çështja gjyqësore e shumë diskutuar prej saj është civile dhe referon konflikte dhe problematika pronësore, të cilat vijnë si pasojë e kundërshtimit të bërë ndaj vendimeve administrative të kthimit të pronës, atyre gjyqësore me objekte të ndryshme, si sigurim padie, pezullim çështje, kundërshtim të vendimeve të bashkimit të çështjeve, kundërshtim të vendimeve të kthimit të pronës, etj. Po ashtu, po nga aktet vërehet se palët kanë konflikte edhe mes tyre si trashëgimtarë të gjyshit të tyre ish-pronar, për të cilët pretendojnë për falsifikime dokumentesh, etj. Denoncuesja nuk adreson shkelje konkrete ndaj subjektit të rivlerësimit. Konkretisht, nga aktet e administruara, subjekti i rivlerësimit identifikohet (sikurse ka rezultuar edhe më sipër në trajtimin e denoncimit nr. 8) vetëm në një vendimarrje të datës 28.2.2018, me objekt pezullimin e gjykimit të çështjes civile kërkuar pikërisht nga znj. M.B dhe të tjerë me cilësinë e paditëses, me palë të paditur shoqërinë “****” sh.p.k. Në këtë rast, subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës.

14.3 Nga trajtimi i këtij denoncimi, Komisioni nuk identifikon fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

15.Denoncim¹¹¹ i shtetasit A.D

15.1 Denoncuesi ankohet për vendimarrje të padrejtë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procesin gjyqësor për konflikt pronësie, sipas tij, për pasurinë që ai trashëgon ndër vite. Ai e lidh vendimarrjen edhe me pozitën e vajzës së subjektit si drejtuese e ASHK-së Berat, për shkak se sipas tij çështja konflikt gjyqësor ka si person të tretë edhe këtë institucion, i cili sipas padisë kërkohet që, ndër të tjera, të bëjë edhe regjistrimin e një sipërfaqeje tokë - truall të pretenduar nga denoncuesi (me cilësinë e paditësit) se është e tij dhe se kur nga përfaqësuesja e tij është kërkuar që t'i merret informacion ASHK-së, subjekti i rivlerësimit ka orientuar që kërkimi të bëhet në portalin *e-albania*. Për këtë shkak denoncuesi pretendon se vendimarrja e rrëzimit është e ndikuar nga ankesa e tij në ASHK. Denoncuesi, ndër të tjera, ka depozituar vendimin gjyqësor nr. ***, datë 22.7.2022, dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me të cilin është rrëzuar padia e tij me objekt detyrim për njohje pronar, lirim e dorëzim pasurie, shpërblim dëmi dhe regjistrim pasurie në hipotekë. Nga të dhënat e vendimit rezulton se çështja ka zgjatur rreth 19 muaj (regjistruar në datën 22.12.2020) dhe se në këtë

¹⁰⁸Nr. *** prot., datë 27.7.2020, ardhur nga IKP me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2020.

¹⁰⁹Nr. *** prot., datë 12.2.2019 për të cilin është administruar një CD e përcjellë nga IKP-ja.

¹¹⁰Me shkresën nr.*** prot., datë 30.5.2022.

¹¹¹Nr. *** prot., datë 3.8.2022.

vendimmarrje ka munguar prezenca e përfaqësuesit të ASHK-së. Denoncuesi konfirmon se ka ushtruar të drejtën ankimore ndaj këtij vendimi, çka në këto kushte duket se trajtimi i saj nuk është në kompetencë të Komisionit.

15.2 Për sa më sipër, Komisioni¹¹² i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë arsyet e kohëzgjatjes së gjykimit, si dhe të depozitohë dokumentacion provues, pasi dukej se ishte vepruar në kundërshtim me pikën 5, germën “e” të Aneksit nr.1 të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të ish-KLD-së, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”.

15.3Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij ka kundërshtuar pretendimet e denoncuesit me argumentin se ato nuk qëndrojnë duke theksuar se:(i) seancat gjyqësore janë shtyrë për shkak të palëve, ekspertëve, ngarkesa e punës së gjyqtarit, delegimi i gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) asnjëherë nuk është bërë pengesë gjykata për moszhvillimin e gjykimit dhe për kohëzgjatjen e saj.

15.4 Komisioni, për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës dhe për shkak të pretendimeve të denoncuesve, i ka kërkuar gjykatës numrin e çështjeve të gjykuara nga subjekti me palë ndërgjyqëse ose person i tretë ASHK/Drejtoria Vendore Berat, prej periudhës shkurt 2021 e deri aktualisht, kohë në të cilën ka ushtruar dhe ushtron detyrën e drejtueses së kësaj të fundit, vajza e subjektit të rivlerësimit O.Z. Në përgjigje, gjykata ka konfirmuar¹¹³ se janë gjykuar 12 çështje, ku palë ndërgjyqëse ose person i tretë ka qenë ASHK/Drejtoria Vendore Berat, prej datës 16.2.2021 e deri aktualisht.

15.5 Për sa më sipër, Komisioni vërejt se dukej se gjatë shqyrtimit të 12 çështjeve gjyqësore me palë pjesëmarrëse në proces ka qenë ASHK-ja, drejtuese e së cilës është vajza e subjektit dhe, për rrjedhojë,dukej se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në këto gjykime, sipas parashikimit të bërë në dispozitat përkatëse të kreut V të Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 9367/2005, si dhe në mospërputhje me nenet 3/4, 4/2 e në vijim, të ligjit nr.96/2016. Për pasojë, Komisioni i kërkoi¹¹⁴ subjektit të rivlerësimit të japë sqarime dhe të paraqesë dokumentacion në lidhje me këtë konstatim.

15.6 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me situatën e konfliktit të interesit:(i) ka pasqyruar një ndarje të çështjeve sipas kohës së gjykimit, objektit të gjykimit dhe pozicionit të këtij institucioni/ASHK Drejtoria Vendore Berat, si palë ndërgjyqëse;(ii) ka qartësuar se në të gjitha proceset e zhvilluara në kohën kur vajza e tij ka qenë në detyrën e drejtueses, institucioni që ajo përfaqëson ka qenë në cilësinë e personit të tretë; (iii) personi i tretë nuk ka pasur ndonjë rol në gjykim dhe asnjë interes të ligjshëm; (iv) vendimmarrjet ndaj personit të tretë nuk i shtrijnë efektet për personin e tretë; (v) thirrja e personit të tretë në proces bëhet për të krijuar vetë pala që vë në lëvizje gjykatën, lehtësira në marrjen e informacionit.

Po ashtu, subjekti ka dhënë shpjegime referuar legjislacionit përkatës si në Kodin e Procedurës Civile dhe në atë të parandalimit të konfliktit të interesit, duke qartësuar edhe kompetencat e drejtuesit të institucionit. Ndërkohë, subjekti ka pretenduar se në asnjë rast të gjykimit të këtyre çështjeve nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti ka depozituar të gjitha vendimet gjyqësore, procesverbalet, raporte shëndetësore dhënë për të, kalendarin e gjykimeve, delegimin e tij për të gjykuar një çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe udhëzimin nr. 600, datë 11.2.2021,të ASHK-së“Për rregullat e përfaqësimit, raportimit dhe ndërveprimit në institucionet shtetërore në çështjet gjyqësore”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

¹¹²Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹¹³Shkresë nr.*** prot., datë 26.9.2022.

¹¹⁴Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

15.7 Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna në mënyrë të detajuar duke iu referuar edhe legjislacionit përkatës, por edhe nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, konstaton se: (i) në të gjitha vendimet, ASHK/Drejtoria Vendore Berat është në cilësinë e personit të tretë; (ii) sipas udhëzimit të këtij institucioni, i cili rregullon procesin e ankimit ndaj vendimmarrjeve, rezultoi se kjo e drejtë ushtrohet vetëm në rastet kur nga vendimmarrjet cenohet interesi i ligjshëm i institucionit; (iii) për faktin se në të gjitha proceset gjyqësore rezultoi se institucioni ku drejtuese është vajza e subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e personit të tretë dhe, për pasojë, duke mos u tërhequr interesi i ligjshëm nga institucioni, kjo e drejtë nuk ushtrohet; (iv) në rastin objekt i këtij denoncimi procesi gjyqësor është në të njëjtin stad, pra konflikti është mes individëve dhe institucioni si person i tretë ka një rol tërësisht pasiv, vlerësohet se në këtë rast nuk cenohet asnjë prej dispozitave ligjore si në Kodin e Procedurës Civile dhe as në ligjin nr.9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Më konkretisht, duket të mos ketë rrethana konkrete apo arsye serioze njëanshmërie si një kërkesë e vetme që mbetet në zbatimin e nenit 72 të këtij Kodi, në këto raste gjykimi, pasi kërkesat e tjera duket të jenë të përjashtuara apo edhe përsa kohë duket të mos ketë shkaqe të arsyeshme për t’u vlerësuar me ndërgjegje nga subjekti, për sa kohë konfirmohet pozita e institucionit të ASHK-së/Drejtoria Vendore Berat në këto procese, roli dhe pasojat e tij. Gjithashtu, edhe referuar ligjit nr.96/2016 apo edhe ligjit nr.9367/2005, duket se konflikti i interesit, në raport me pozitën e palës ndërgjyqëse në proces, mbetet në nivel të parëndësishëm.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e denoncuesit për zvarritje të procesit gjyqësor, nisur nga shpjegimet konkrete të subjektit në raport edhe me procesverbalet e depozituara ku reflektohen arsyet e shtyrjes së seancave apo edhe për shkaqe të tjera objektive në nivel provueshmërie si marrja e raporteve për paaftësi të përkohshme, ngarkesa në punë, delegimi për të gjykuar në gjykatë tjetër, etj., Komisioni vlerëson se kohëzgjatja e procesit gjyqësor është në raport me vetë çështjen gjyqësore që duket të ketë qenë komplekse, për të cilën janë pasqyruar edhe arsyet objektive të shtyrjes në procesverbalet përkatëse.

Në të tilla kushte duket se nuk vërehen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional apo etik të subjektit.

Për sa u arsyetua më sipër, Komisioni, pas analizimit të denoncimeve, referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar se në tërësi ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.

Vlerësimi tërësor i çështjes

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

- a. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe

mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

- b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Pëllumb Zaimi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.10.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka